



Dishepullimi i vërtetë

William MacDonald

Dishepullimi i Vërtetë

© 2000, Pogradec
Asambleja Biblike

Originali: True Discipleship, 1975
Walterick Publishers
Kansas City, KA 66110, U.S.A.

Pa autorizim nga William MacDonald nuk lejohet shtypja
apo riprodhimi i tekstit.

Citimet biblike në shqip janë nga:
bibla, «Diodati i Ri» (1991-1994)
Përdorur me leje nga ALBANIA BIBLE SOCIETY
A.B.S., TIRANË

Parathënie

Ky libër është një përpjekje për të shpallur parime nga Dhiata e Re për dishepullimin. Disa nga ne i kanë parë këto parime në Fjalën për shumë vjet, por në njëfarë mënyre konkluduan që ato ishin ekstreme dhe jopraktike për kohën e ndërlikuar në të cilën ne jetojmë. Pra, ne iu dorëzuam ftohtësisë së mjedisit tonë frymëror.

Pastaj takuam një grup besimtarësh të rinj të cilët u nisën të tregojnë se kushtet e Krishtit për një dishepull të Tij janë jo vetëm shumë praktike por edhe kushtet e vetme me të cilat do të ungjillëzohet bota.

Ne pranojmë se jemi borxhlinj ndaj këtyre të rinjve sepse ata na dhanë shumë shembuj të gjallë për shumë gjëra që janë shkruar në këtë libër.

N.q.s. këto të vërteta janë akoma përtej eksperiencës sonë personale, ne i vendosim ato përpara nesh si qëllime të zemrës sonë.

- William MacDonald, 1975

Hyrje

Rruga drejt dishepullimit të vërtetë fillon kur një njeri lind përsëri. Ajo fillon kur gjërat e mëposhtme ndodhin:

1. Kur një njeri e kupton që është mëkatar, i humbur, i verbër dhe lakuriq frymërisht përpara Perëndisë.
2. Kur ai e kupton që nuk mund të shpëtojë veten me anë të karakterit të mirë apo nëpërmjet veprave të mira.
3. Kur ai beson që Zoti Jezus Krisht vdiq si zëvendësuesi i tij mbi kryq.
4. Kur me një vendim të saktë të besimit, ai pranon Jezu Krishtin si Zotin dhe Shpëtimtarin e tij të vetëm.

Kështu bëhet një njeri i krishterë. Është e rëndësishme të theksojmë këtë në fillim. Shumë njerëz mendojnë që mund të bëhesh një i krishterë duke u përpjekur të jetosh një jetë të krishterë. Asnjëherë! Ti duhet të bëhesh një i krishterë përpara se të jetosh jetën e krishterë.

Jeta e një dishepulli të vërtetë që do të përshkruhet në këtë libër është një jetë e mbinatyrshme. Ne nuk kemi fuqi brenda vetvetes që ta jetojmë. Kemi nevojë për fuqi hyjnore. Vetëm kur të jemi lindur përsëri mund të marrim fuqinë që të jetojmë si Jezusi na mësoi.

Përpara se të lexosh më shumë, pyet vetveten: "A jam unë i rilindur? A jam bërë unë një fëmijë i Perëndisë me anë të besimit tek Zoti Jezus?"

N.q.s. "jo", atëherë pranoje atë tani si Zot dhe Shpëtimar. Pastaj, vendos t'i bindesh Atij në të gjitha ato që Ai na ka udhëruar, cilido qoftë çmimi.

Kushtet e dishepullimit

Krishterimi i vërtetë është një përkushtim i plotë ndaj Zotit Jezus Krisht. Shpëtimtari nuk kërkon burra e gra që t'i dedikojnë Atij mbrëmjet e tyre të lira, pushimet apo vitet e fundit të jetës kur dalin në pension. Përkundrazi, Ai kërkon ata që do t'i japin atij vendin e parë në jetën e vet. Sipas fjalëve të Evan Hopkins: "Ai kërkon sot, siç ka bërë gjithmonë, jo turmat apatike që e ndjekin pa asnjë plan, por burra e gra që besimi i tyre i patundur të vijë nga njohja që Ai dëshiron individë të përgatitur për të ndjekur shtegun e mohimit të vetvetes që Ai ndoqi përpara tyre."

Asgjë tjetër, veç një dorëzimi të përkushtuar s'mund të jetë një përgjigje e denjë ndaj sakrificës së Tij përgjatë Kalvarit. Një dashuri kaq e madhe, kaq hyjnore nuk mund të kënaqet përveçse me dhuratën e shpirtit tanë, të jetës tonë, të të gjithë qenies sonë.

Zoti Jezus kishte kërkuar gjëra të vështira nga ata që dëshironin të ishin dishepujt e Tij, kërkesa që harrohen pothuajse krejtësisht në këto ditë të kësaj jete komode. Shumë shpesh krishterimi nuk është gjë tjetër për ne përveçse mënyrë për t'i shpëtuar ferrit dhe garanci për të shkuar në qiell. Pas kësaj, kemi të drejtën e plotë për të shijuar të mirat që ofron jeta. E dimë mirë që Bibla përmban vargje shumë të fuqishme për dishepullimin, por e kemi të vështirë t'i pajtojmë ato vargje me idetë tona siç duhet të jetë krishterimi.

Ne mund ta pranojmë faktin se disa ushtarë japin jetën e tyre për arsye patriotike. Nuk na duket e çuditshme që komunistët të japin jetën e tyre për një ideal politik, por që "lot, djersë dhe gjak" të karakterizojnë jetën e një ndjekësi të Krishtit na duket e çuditshme dhe e vështirë për t'u kuptuar.

Sidoqoftë, fjalët e Zotit Jezus janë mjaft të qarta. Nuk ka asnjë mundësi keqkuptimi në qoftë se i marrim për atë që thonë. Ja kushtet për të qenë një dishepull i vërtetë, të shprehura nga Shpëtimtari i botës.

1. Një dashuri e pakufishme për Jezus Krishtin.

"Nëse ndokush vjen tek unë dhe nuk urren babanë e vet, nënën e vet, gruan dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im" (Lluka 14:26). Kjo nuk do të thotë që duhet të kemi ndjenja urrejtjeje në zemër kundër të afërmëve tanë, por do të thotë që dashuria jonë për Krishtin duhet të jetë aq e madhe sa që të duket urrejtje përpara çfarëdo lloj dashurie tjetër. Në të vërtetë, shprehja më e vështirë e gjithë kësaj pjese është: "madje edhe jetën e vet." Dashuria për vetveten është ndër pengesat më të rrezikshme për dishepullimin. Vetëm kur do të jemi të gatshëm të sakrifikojmë jetën tonë do të jemi në gjendjen që Ai na do.

2. Një mohim i vetvetes.

"Në qoftë se dikush do të vijë pas meje, ta mohojë vetveten..." (Mateu 16:24). Mohimi i vetvetes nuk do të thotë privim nga disa ushqime, nga disa kënaqësi apo disa zotërime, por nënshtrim kaq të plotë ndaj autoritetit të Krishtit sa që "vetja" s'ka asnjë të drejtë apo autoritet. Kjo do të thotë që "vetja" ka hequr dorë nga froni i saj, prej vendit të parë në jetën tënde. Pikërisht siç e shprehin fjalët e Henri Martinit: "O Zot, mos lejo që unë të kem një vullnet timin apo që unë të vlerësoj lumturinë time të vërtetë sadopak të varur nga ndonjë gjë që mund të vijë nga jashtë, por që të konsistojë vetëm në ngjashmëri me vullnetin tënd."»

Fitimtari imi lavdishëm, Princ hyjnor,
merri këto duar të dorëzuara në duart e tua,
vullneti im është i gjithë yti,
vasalë të gëzuar të një froni të Shpëtimtarit
— H.G. Moule

3. Një zgjedhje e ndërgjegjshme e kryqit.

"Në qoftë se dikush don të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, ta marrë kryqin e vet..." (Mateu 16:24). Kryqi nuk është një sëmundje fizike apo një ankth mendor: këto gjëra janë të përbashkëta për të gjithë njerëzit. "Kryqi është një shteg i zgjedhur me ndërgjegje dhe, në sytë e botës, një shteg çnderimi dhe përçmimi." - C.A. Coates. Kryqi është simboli i turpfit, i persekutimit dhe i poshtërimit që bota hodhi mbi Birin e Perëndisë, dhe që bota do të hedhë mbi gjithë ata që do të kërkojnë të shkojnë kundër rrymës. Një besimtar mund ta shmangë kryqin duke u konformuar me botën dhe rrugët e saj.

4. Një jetë që ndjek Krishtin.

"Në qoftë se dikush don të vijë pas meje, ta mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë..." (Mateu 16:24). Për të kuptuar domethënien është e nevojshme thjesht të pyesim: "Çfarë karakterizoi jetën e Zotit Jezus?" Ishte një jetë bindjeje ndaj vullnetit të Perëndisë. Ishte një jetë e jetuar në fuqinë e Frymës së Shenjtë. Ishte një jetë shërbimi pa egoizëm ndaj të tjerëve. Ishte një jetë durimi dhe qëndrueshmërie kundër padrejtësive më të mëdha. Ishte një jetë që u harxhua për shkakun e Perëndisë, plot me zell, vetëkontroll, përlulesi, mirësi, besnikëri dhe dashuri (Galatasve 5:22-23). Që të mund të jemi dishepujt e Tij, duhet të ecim ashtu siç eci Ai. Duhet të manifestojmë frytin e përngjasimit të Krishtit në jetën tonë (Gjoni 15:8).

5. Një dashuri e zjarrtë për gjithë ata që i përkasin Krishtit.

"Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin" (Gjoni 13:35). Kjo është dashuria që çmon të tjerët më shumë se vetveten; është dashuria që mbulon një shumicë mëkatesh; është dashuria që duron çdo gjë dhe është dashamirëse, që nuk krenohet, që nuk sillet në mënyrë të padenjë, nuk kërkon interesin e vet, nuk pezmatohet, nuk dyshon për keq, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, i duron të gjitha (1 Kor. 13:4-7). Pa këtë dashuri, dishepullimi do të ishte vetëm një asketizëm i ftohtë dhe legalist.

6. Një qëndrueshmëri e fortë në fjalën e Tij.

"Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë dishepujt e mi" (Gjoni 8:31). Për të qenë dishepuj të vërtetë është e nevojshme qëndrueshmëria. Është shumë e lehtë të fillosh mirë, të lëshohesh përpara në një valë lavdërimi, por prova e realitetit është ngulmi deri në fund. "Asnjëri që ka vënë dorë në parmendë dhe kthehet e shikon prapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë" (Lluka 9:62). Nuk mjafton t'i bindemi Shkrimeve kur kemi kohë, Krishti do persona që i binden pa rezervë, në mënyrë të qëndrueshme.

7. Heqja dorë nga të gjitha për ta ndjekur.

"Kështu, pra secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im" (Lluka 14:33). Ky ndoshta është vargu më pak i njohur i të gjithë kushteve të Krishtit për dishepullim, dhe mund të jetë vargu më i urryer i Biblës. Teologë me emër do të jenë në gjendje t'ju japin me mijëra arsye përse ky varg nuk do të thotë atë që thotë, por dishepujt e thjeshtë e pranojnë me shumë gëzim, duke pranuar që Zoti Jezus e dinte atë që thoshte. Çfarë do të thotë me lënien e të gjithave? Do të thotë heqja dorë nga të gjitha zotërimet materiale që nuk janë jashtëzakonisht të nevojshme dhe që mund të përdroreshin në fakt për përhapjen e Ungjillit. Ai që heq dorë nga të gjitha nuk bëhet një përtac. Përkundrazi ai punon shumë për të furnizuar familjen e tij me nevojat e tanishme të jetës. Por në realitet, pasioni i jetës së tij është përparimi i çështjes së Krishtit, ai do të investojë gjithçka, përtej nevojave të tanishme të tij në punën e Zotit duke besuar tek Perëndia për të ardhmen. Duke kërkuar përpara së gjithash mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij, ai beson që nuk do t'i mungojnë kurrë as ushqimi, as vjeshja. Ndërgjegjja nuk ia lejon të mbajë për vete atë që është e tepërt për të, ndërkohë që ka shpirtra që humbin nga mungesa e Ungjillit.

Nuk do ta kalojë jetën e tij duke grumbulluar pasuri, që do të bien në duart e djallit kur Krishti të kthehet për të rrëmbyer shenjtorët e Tij. Ai dëshiron t'i bindet urdhërit të Zotit kundër grumbullimit të pasurisë mbi tokë. Në braktisje të çdo gjëje, ofron atë që në fund të fundit nuk mund ta mbajë dhe atë që ka pushuar së dashuri.

Këto janë pra, shtatë kushtet e dishepullimit të krishterë. Ato janë të qarta dhe të palëvizshme. Shkrimtari e kupton që në mënyrën si i paraqet, ka dënuar veten si shërbëtor i pavlefshëm. Por a duhet të pushojë gjithmonë e vërteta e Perëndisë për shkak të dështimeve të popullit të Perëndisë? A nuk është e vërtetë që mesazhi është gjithnjë më i madh se ai që e përhap? A nuk është e drejtë të thuhet që Perëndia është i vërtetë dhe çdo njeri gënjeshhtar?

Duke rrëfyer dështimet tona, le të përballojmë me kurajë kushtet e Krishtit mbi jetën tonë dhe të kërkojmë tash e mbrapa të jemi dishepuj të vërtetë të Shpëtimtarit tonë të lavdishëm.

Duke hequr dorë nga të gjitha

"Kështu, pra secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im" (Lluka 14:33).

Për të qenë një dishepull i Zotit Jezus, një njeri duhet të heqë dorë nga të gjitha. Ky është kuptimi i padiskutueshëm i fjalëve të Shpëtimtarit. Sado që ne të kundërshtojmë një kërkesë të tillë të "jashtëzakonshme", sado që të rebelojmë kundër këtij mësimi të "pamundur" dhe të "pamend", fakti është që kjo është Fjala e Zotit, dhe Ai e ka me gjithë mend atë që thotë.

Në fillim, ne duhet të përballojmë këto të vërteta të padiskutueshme:

1. Jezusi nuk e kërkoi këtë nga një grup i zgjedhur punëtorësh të krishterë. Ai tha: "Kështu, pra secili nga ju...».

2. Ai nuk tha që ne thjesht duhet të jemi të gatshëm të heqim dorë nga të gjitha. Ai tha: "Kështu, pra secili nga ju që nuk heq dorë...».

3. Ai nuk tha që duhet të heqim dorë vetëm nga një pjesë e pasurisë sonë. Ai tha: "Kështu, pra secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka...".

4. Ai nuk tha që një version tjetër i dishepullimit është i mundshëm, një version sipas të cilit një njeri mund t'i mbajë thesaret e tij. Ai tha: "...nuk mund të jetë dishepulli im".

Në fakt, nuk duhet të habitemi nga kjo kërkesë absolute, sikur ky të ishte i vetmi "sugjerim" i tillë nga Bibla. A nuk tha Jezusi: "Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell... (Mat. 6:19, 20)"? Si z. Wesley tha: "Zoti ynë na ndalon të mbledhim thesare mbi tokë siç na ndalon të shkelim kurorën dhe të vrasim".

A nuk tha Jezusi: "Shitni pasurinë tuaj dhe jepni lëmoshë..." (Lluka 12:33)?

A nuk e urdhëroi Jezusi pasanikun e ri: "...shit gjithçka që ke dhe jepua të varfërve dhe do të kesh një thesar në qiell: pastaj eja e më ndiq" (Lluka 18:22)?

N.q.s. nuk e tha me gjithë mend, atëherë çfarë donte të thoshte Ai?

A nuk ishte e vërtetë që besimtarët në kishën e parë "i shisnin pronat e pasuritë dhe ua ndanin të gjithëve, sipas nevojës së çdonjërit" (Vep. 2:45)?

A nuk ka qenë e vërtetë për shumë besimtarë gjatë shekujve që kanë hequr dorë nga të gjitha për të ndjekur Krishtin?

Anthony Norris Groves dhe gruaja e tij, misionarë në Bagdad, u bindën që "ata duhet të pushonin së mbledhuri thesare mbi tokë, dhe duhet t'ia përkushtonin të gjithë pasurinë punës së Zotit" ("Men of His Right Hand" ose "Njerëzit e dorës së Tij të djathtë", REVISTA DËSHMITARI, janar 1961). Bindjet e z.

Groves mbi këtë temë janë shkruar në librin e tij "Përkushtim i krishterë" (Nga Walterick Publishers, Kansas City, KA, 66110, U.S.A.).

C. T. Studd "vendosi t'ia jepte të gjithë pasurinë e tij Krishtit dhe ta shfrytëzonte mundësinë e madhe që iu dha për të bërë atë që pasaniku kishte dështuar ta bënte. ...Ishte vetëm bindje ndaj thënieve bardhë e zi të Fjalës të Zotit" (Grubb, Norman, "C.T. Studd", Lutterworth Press, 1957, f. 64). Pas shpërndarjes së shumë parave në punën e Zotit, ai mbajti \$9588 për nusen e tij të re. Me të njëjtin zell si burri i saj, ajo e pyeti, "Çarli, çfarë i urdhëroi Jezusi pasanikut të ri të bënte?" "Shit gjithçka", u përgjigj ai. "Atëherë, ne do të fillojmë pikërisht me Zotin në martesën tonë", tha ajo. Dhe të gjithë pasuritë shkuan tek misionarët e krishterë.

Jim Elliot kishte të njëjtin shpirt të përkushtuar. Ai shkroi në ditarin e tij:

"Atë, më lejo të jem i dobët që të humbas shtrëngimin mbi gjithçka të përkohshme: jeta ime, reputacioni im, zotërimet e mia. Zot, më lejo të zgjidh tensionin e dorës së shtrënguar. Madje, Atë, mund të humbisja të zgjidhja dashurinë e prekjës përkëdhelëse. Sa shpesh unë kam lëshuar një shtrëngim vetëm të mbaj atë që çmoj me një mall të "padëmshëm" ose me një prekje përkëdhelëse. Përkundrazi, hape dorën time të marrë gozhdën e Kalvarit, si dora e Krishtit ishte hapur, që unë, duke lëshuar gjithçka, të lëshohem, të çlirohem nga të gjitha që më lidhin tani. Ai nuk çmoi qiellin, madje barazimin me Perëndinë, si një gjë që ta mbante fort. Pra, më lejo të lëshoj shtëngimin tim" (Elisabeth Elliot, "Hija e të Plotfuqishmit", Harper and Brothers, 1958, f. 246).

Zemra jonë e pabesë na tregon që nuk ka mundësi t'i besojmë fjalët e Zotit fjalë për fjalë. N.q.s. ne do të hiqim dorë nga të gjitha do të vdisim nga uria. A nuk kuptojmë ne që duhet të sigurojmë të ardhmen tonë dhe të ardhmen e të dashurve tanë? N.q.s. të gjithë të krishterët do të hiqin dorë nga të gjitha, atëherë kush do ta financonte punën e Zotit? N.q.s. nuk do të kishte disa besimtarë të pasur, atëherë kush do ta çonte ungjillin tek pasanikët? Kështu vijnë me radhë shumë argumente për të provuar që Jezusi nuk foli me gjithë mend.

Fakti është që bindja ndaj urdhërimit të Zotit është jeta më e arsyeshme, më e mençur dhe ajo që jep gëzimin më të madh. Shkrimet e Shenjta dhe eksperiencia dëshmojnë që asnjëri që dëshiron të jetojë me sakrificim për shkak të Krishtit nuk ka vuajtur kurrë nga ndonjë mungesë. Kur një njeri i bindet Perëndisë, Zoti kujdeset për atë.

Njeriu që heq dorë nga të gjitha për të ndjekur Krishtin nuk është një lypës që kërkon para nga besimtarët. Përkundrazi,

1. Ai është punëtor. Ai punon fort për nevojat e tanishme të tij dhe së familjes së tij.
2. Ai ka kujdes me paratë. Ai jeton ekonomikisht që gjithçka përtej nevojave të tanishme të mund të investohet në punën e Zotit.
3. Ai parashikon. Ai nuk grumbullon pasuri mbi tokë, por mbledh thesaret e tij në qiell.
4. Ai beson tek Perëndia për të ardhmen. Ai nuk i jep më të mirën e jetës së tij ndërtimit të shumë rezervave parash për pleqëri, por i jep më të mirën shërbesës së Krishtit dhe beson tek Ai për të ardhmen. Ai beson që nëse para së gjithash kërkon mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij, nuk do t'i mungojë ushqimi dhe veshja (Mat. 6:33).

Për të, është pa mend të grumbullojë pasuri për ditë fatkeqësie. Një dishepull i vërtetë do të arsyetonte kështu:

1. Me ndërgjegje, si mund të grumbullojmë ne para përtej nevojave tona kur këto para

mund t'i përdorim tani për shpëtimin e njerëzve? "[...] nëse njëri ka të mirat e kësaj bote dhe sheh të vëllanë që është në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?" (1 Gjo. 3:17).

"Përsëri, mbaj mend urdhërimin e rëndësishëm - «por do ta duash të afërmin tënd si veten tënde» (Lev. 19:18). A mund të thuhet që ne e duam të afërmin tonë si veten tonë kur kemi më shumë se sa njafton por e lëmë atë të vdesë nga uria? Mos i bëshfa thirrje askujt që ka njohur gëzimin e dhuratës së Perëndisë të patregueshme dhe pyes: «A do të këmbesh këtë njohuri [...] për një qind botëra?». Pra, le të mos mbajmë mjetin me anë të të cilit të tjerët mund të marrin këtë njohuri shenjtërore dhe ngushëllimin qiellor" - A.N. Groves.

2. Nëse besojmë me të vërtetë që ardhja e Krishtit është e afërt, do të duam t'i përdorim paratë tona menjëherë. Përndryshe ka rrezik që ato do të bien në dorën e djallit, para se ajo të mund të përdorej për bekime të përjetshme.

3. Si mund t'i lutemi Zotit me ndërgjegje të plotë që të furnizojë financim për punën e krishterë kur ne kemi para të cilat nuk jemi gati për t'i përdorur për të njëjtin qëllim? Duke hequr dorë nga çdo gjë ne shpëtohem nga hipokrizia kur lutemi!

4. Si mund t'u mësojmë ne të gjithë Shkrimet e Shenjta të tjerëve nëse janë gjëra (p.sh. po heq dorë nga çdo gjë) që nuk i kemi zbatuar? Në këtë rast, jeta jonë do të mbyllte gojën tonë.

5. Njerëzit e zgjuar të botës mbajnë rezerva të mëdha të parave për të ardhmen. Duke e bërë këtë nuk ecin nëpërmjet besimit por nëpërmjet shikimit. Besimtari është thirrur për një jete varësie ndaj Perëndisë. Nëse ai mban thesare mbi tokë, nga ndryshon ai nga bota dhe rrugët e saj?

Dëgjohet shpesh argumenti që ne duhet të kujdesemi për nevojat e ardhshme të familjes sonë. Përndryshe, jemi më të këqij se jobesimtarët. Vargjet e mëposhtshme përdoren për të mbështetur këtë ide:

«... sepse bijtë nuk e kanë për detyrë të mbledhin për prindërit, por prindërit për bijtë» (2 Kor. 12:14)

«Por në qoftë se dikush nuk kujdeset për të vetët, dhe më tepër për ata të shtëpisë, ai e ka mohuar besimin dhe është më i keq se një jobesimtar» (2 Tim. 5:8)

Një shqyrtim i kujdesshëm i këtyre vargjeve tregon që ata flasin për «nevoja të tanishme» dhe jo për «mundësi të ardhshme.»

Në 2 Kor. 12:14 Pali po përdor ironi. Ai është prindi dhe besimtarët e Korinit janë fëmijët e tij. Ai nuk i ka ngarkuar ata financiarisht, megjithëse kishte të drejtë ta bënte këtë si shërbëtor i Zotit. Ai ishte ati i tyre në besimin dhe prindërit normalisht kujdesen për fëmijët dhe jo anasjelltas. Kjo pjesë nuk ka asnjë lidhje me idenë që prindërit duhet të mbledhin gjëra për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Përkundrazi, vargu flet për nevojat e tanishme të Palit, jo për nevojat e mundshme të tij në të ardhmen.

Në 1 Tim. 5:8, apostulli diskutonte për kujdesjen e vejushave të varfra. Ai insiston që të afërmit e tyre kanë përgjegjësi për t'u kujdesur për to. Nëse një e ve nuk ka njerëz ose nuk e përmbushin përgjegjësinë e tyre, atëherë kisha lokale duhet të kujdeset për vejushat e krishtera. Por, përsëri, Pali flet për nevojat e tanishme, jo për nevojat e ardhshme.

Qëllimi i Perëndisë është që gjymtyrët e trupit të Krishtit duhet të kujdesen për nevojat e tanishme të besimtarëve: "...Ai që mblodhi shumë, nuk mori më shumë dhe ai që mblodhi pak, nuk mori më pak"

(2 Kor. 8:15).

Një besimtar që ndjehet se duhet të kursejë për të ardhmen do të ndeshet me problemin e vështirë se sa para do të jenë të mjaftueshme. Pra, ai e harxhon jetën e tij duke kërkuar një sasi të pacaktueshme parash dhe i privon vetes privilegjin për t'i dhënë Zotit Jezus Krisht më të mirën nga jeta e tij. Ai arrin në fundin e jetës së tij të harxhuar kot dhe zbulon që të gjitha nevojat e tij do të ishin plotësuar nëse do të kishte jetuar me gjithë zemër për Shpëtimtarin.

Në qoftë se të gjithë besimtarët do t'i zbatonin fjalët e Zotit Jezus Krisht fjalë për fjalë, atëherë nuk do të mungonte paraja për punën e Zotit. Ungjilli do të përhapej me një fuqi më të madhe dhe me më shumë aktivitete. Nëse një dishepull do të kishte ndonjë nevojë, do të ishte një gëzim i madh dhe privilegj për dishepujt e tjerë për t'i dhënë çdo gjë që kishin.

Të nënkuptosh që duhet të ketë besimtarë të pasur për të ungjillëzuar njerëzit e pasur të botës është absurditet. Pali ungjillëzoi shtëpinë e Cezarit kur ishte i burgosur (Fil. 4:22). Nëse ne i bindemi Perëndisë, mund t'i besojmë Atij për të rregulluar hollësitë.

Shembulli i Zotit Jezus Krisht duhet të jetë bindës për këtë çështje. Shërbëtori nuk është më i madh se sa i zoti. Xhorxh Muller tha: «Nuk shkon mirë nëse shërbëtori kërkon të jetë i pasur, i madh, dhe i nderuar në këtë botë ku Zoti i tij ishte i varfër, i përlulur dhe i keqtrajtuar».

A. N. Groves tha: «Vuajtjet e Krishtit përfshijnë varfërinë (2 Kor. 8:9). Pa diskutim, kjo nuk do të thotë që një njeri duhet të vishet me rroba të grisura dhe të jetë pis, por këtu përfshihet mungesa e rezervave të parave dhe një jetë në luks.... Përpara tredhjetë vjetësh, Andrew Murray tha që Zoti dhe dishepujt e Tij nuk do të kishin mundur ta kryenin punën e tyre që ata kishin për të bërë po të mos kishin qenë të varfër. Ai që ka dëshirë për të lartësuar një njeri tjetër duhet të përulet, si Samaritani (Llu. 10:33-34), dhe shumica e njerëzve gjithmonë ka qenë dhe është tani e varfër»

Njerëzit mbrojnë çështjen që janë disa gjëra të veçanta materiale që janë të domosdoshme për jetën familjare. Kjo është e vërtetë.

Njerëzit argumentojnë që një biznesmen i krishterë duhet të ketë një sasi kapitali për të vazhduar biznesin në ditët e sotme. Kjo është e vërtetë.

Njerëzit ngulin këmbë që janë gjëra të tjera materiale (p.sh. një automobil) që mund të përdoren për lavdinë e Perëndisë. Edhe kjo është e vërtetë.

Por përtej këtyre gjërave të domosdoshme besimtari duhet të jetojë me kursim dhe me sakrificë për përhapjen e ungjillit. Motoja e tij duhet të jetë: «Puno shumë, konsumo pak, jepi shumë dhe gjithçka Krishtit» (A. N. Groves).

Përpara Perëndisë, secili nga ne duhet të caktojë domethënien personale për urdhërimin e Krishtit «Kështu, pra secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im». Një besimtar nuk mund t'i përshkruajë domethënien tjetrit. Sidoqoftë, çdo besimtar duhet ta përcaktojë zbatimin personal të jetës së vet.

N.q.s. një besimtar do të kërkojë me gjithë zemër për ta zbatuar dhe do të rritet aq shumë në përkushtimin e tij ndaj Zotit që deri tani ka qenë i panjohur, nuk ka asnjë vend për krenari personale. Çdo sakrificë që bëjmë, në të vërtetë nuk është sakrificë fare kur e shohim në dritën e Kalvarit. Përveç kësaj, ne i japim Zotit vetëm atë që nuk mund ta mbajmë dhe atë që kemi pushuar së dashuri.

«Nuk është budalla ai që jep atë që nuk mund ta mbajë për të fituar atë që nuk mund të humbasë» - Jim Elliot.

Pengesat Ndaj Dishepullit

Kushdo që fillon të ndjekë Krishtin mund të jetë i sigurt që shumë pengesa do të dalin para tij. Atij do t'i jepen shumë mundësi për t'u kthyer prapa. Zëra të tjerë do ta thërrasin duke premtuar për të prerë disa centimetra nga kryqi. Dymbëdhjetë legjione engjëjsh qëndrojnë gati për ta tërhequr nga rruga e vetëmohimit dhe sakrificës.

Kjo është ilustruar në historinë e tre të ashtuquajturve dishepuj të cilët lejuan që zëra të tjerë të dilnin mbi zërin e Krishtit.

"Ndodhi që, ndërsa po ecnin rrugës, dikush i tha: «Zot, unë do të të ndjek kudo që të shkosh». Por Jezusi i tha: «Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e qiellit fole; kurse Biri i njeriut nuk ka ku ta mbështetë kokën». Pastaj i tha një tjetri: «Ndiqmë!». Por ai përgjigjej: «Zot, më lejo më parë të shkoj e të varros atin tim». Jezusi i tha: «Lëri të vdekurit t'i varrosin të vdekurit e vet; por ti shko dhe prediko mbretërinë e Perëndisë». Akoma një tjetër i tha: «Zot, unë do të të ndjek ty, por më lejo më parë të ndahem me ata të familjes sime». Jezusi i tha: «Asnjëri që ka vënë dorë në parmendë dhe kthehet e shikon prapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë» (Lluka 9:57-62).

Tre burra pa emër erdhën tek Jezu Krishti dhe ishin përballë Atij. Ata ndienin një detyrë të brendshme për ta ndjekur. Por lejuan që diçka tjetër të vinte midis shpirtrave të tyre dhe përkushtimit të plotë ndaj Tij.

Zotëria "tepër i shpejtë"

Njeriu i parë quhet «zotëria "tepër i shpejtë"». Ai doli vullnetar për ta ndjekur Zotin kudo. "Unë do të të ndjek kudo të shkosh." Asnjë çmim nuk do të ishte tepër i madh. Asnjë kryq nuk do të ishte aq i rëndë. Asnjë udhë nuk do të ishte aq e vështirë.

Përgjigjja e Shpëtimtarit duket në fillim sikur nuk ka asnjë lidhje me ofertën e zemrës së hapur të zotërisë "tepër të shpejtë". Jezusi tha: «Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e qiellit fole; kurse Biri i njeriut nuk ka ku ta mbështetë kokën». Në të vërtetë, përgjigjja e Zotit ishte shumë e përshtatshme sepse sikur donte të thoshte: «Ti thua që je gati për të më ndjekur kudo. Por, a je gati të jetosh pa luksin material të jetës? Dhelprat kanë më shumë luks material se sa unë. Zogjtë kanë një fole që mund ta quajnë të tyren. Por unë jam një shtegtar pa shtëpi në botën që duart e mi krijuan. A je gati të sakrifikosh sigurimin e një shtëpie për të me ndjekur mua? A je gati të mos shfrytëzosh luksin material të jetës që të më ndjekësh me përkushtim?»

Siç duket ai njeri nuk ishte gati sepse nuk dëgjojmë më për të në Shkrimet e Shenjta. Dashuria e tij për gjërat tokësore që lehtësojnë jetën ishte më e madhe se dashuria e tij për Krishtin!

Zotëria "tepër i ngadalshëm"

Njeriu i dytë quhet «zotëri "tepër i ngadalshëm"». Ai nuk doli vullnetar si njeriu i parë, por Shpëtimtari e thirri të jetë një dishepull. Përgjigjja e tij nuk ishte një refuzim i hapur, as nuk ishte një përgjigje që tregoi se ai nuk kishte asnjë interes. Përkundrazi, kishte diçka që ai donte të bënte para se të ndiqte Krishtin. Ky ishte mëkati i tij i madh. Ai vuri dëshirat e tij përpara dëshirave të Krishtit. Dëgjo përgjigjen e tij: «Zot, më lejo më parë të shkoj e të varros atin tim».

Pa diskutim, është e mirë dhe e lejueshme që një djalë të respektojë prindërit e tij. N.q.s. babai ka vdekur, është brenda kufijve të besimit të krishterë që ai të varroset me dinjitet.

Por gjërat e lejueshme të jetës bëhen mëkat kur ato kanë të drejtë mbi interesat e Krishtit. Qëllimi i vërtetë i këtij njeriu zbulohet nga kërkesa e hapur: «Zot më lejo më parë...». Fjalët e tjera që ai tha ishin një maskim thjesht për të fshehur dëshirën e brendshme të tij për të vendosur vetveten para së gjithash.

Siç duket ai nuk e kuptoi që fjalët «Zot më lejo më parë...» janë një absurditet moral dhe pamundësi. Nëse Krishti është Zot, atëherë Ai duhet të jetë i pari. Nëse përemri vector "unë" është mbi fron, atëherë Krishti nuk ka kontroll mbi jetën tënde.

Zotëria "tepër i ngadalshëm" kishte një punë për të kryer dhe lejoi punën e tij të jetë e para. Pra, ishte shumë e përshtatshme që Jezusi i tha: «Lëri të vdekurit t'i varrosin të vdekurit e vet; por ti shko dhe prediko mbretërinë e Perëndisë». Fjalët e tij mund t'i shpjegojmë kështu: «Janë disa gjëra që ata të cilët janë të vdekur shpirtërisht mund t'i bëjnë po aq mirë sa edhe besimtarët. Por janë gjëra të tjera në jetë që vetëm besimtarët mund t'i bëjnë. Ki kujdes të mos e harxhosh jetën tënde duke bërë gjërat që një jobesimtar mund

t'i bëjë. Lëri të vdekurit shpirtërorë t'i varrosin të vdekurit shpirtërorë. Por ti, si qëllimin e jetës sate, përhap çështjen Time mbi dhe».

Duket që çmimi ishte tepër i lartë për zotërinë "tepër i ngadalshëm». Ai kaloi nga faqet e Shkrimeve të Shenjta në heshtje të panjohur.

N.q.s. njeriu i parë përfaqëson pengesën e gjërave tokësore që lehtësojnë jetë, i dyti përfaqëson pengesën e një pune ose një karriere që zëvendëson qëllimin kryesor të ekzistencës së një besimtari. Nuk ka asgjë të keqe në një punë të zakonshme. Është vullneti i Perëndisë që një njeri të punojë që të kujdeset për nevojat e tij dhe të familjes së tij. Por, jeta e një dishepulli kërkon që mbretëria e Perëndisë dhe drejtësia e Tij të kërkohej para së gjithash. D.m.th. një besimtar nuk duhet ta harxhojë jetën e tij duke bërë ato gjëra që një jobesimtar mund t'i bëjë. Qëllimi i një pune është të furnizojë nevojat e tanishme kurse qëllimi i një besimtari është predikimi i mbretërisë së Perëndisë.

Zotëria "tepër i lehtë"

Njeriu i tretë quhet «zotëri "tepër i lehtë"». Ai i ngjan njeriut të parë sepse doli vullnetarisht për të ndjekur Zotin. Ai i ngjan edhe njeriut të dytë sepse përdori fjalët kontradiktore «Zot më lejo më parë...». Ai tha «Zot, unë do të të ndjek ty, por më lejo më parë të ndahem me ata të familjes sime».

Përsëri duhet të pohojmë që nuk është kundër ligjit të Perëndisë që një besimtar t'i tregojë të afërmeve të tij dashuri kur duhet të largohet prej tyre. Çfarë gabimi, pra, bëri ai? Çfarë pike të provës nuk kaloi? Gabimi i tij ishte që ai lejoi lidhjet familjare natyrore të zëvendësojnë Krishtin.

Me anë të perceptimit parashikues Zoti Jezus tha «Asnjeri që ka vënë dorë në parmendë dhe kthehet e shikon prapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë». D.m.th. «Dishepujt e mi nuk janë nga ai lloj egoistësh të dhjamosur që je ti. Unë dua ata që janë gati të braktisin lidhjet familjare, që nuk do të tërhiqen nga lidhjet sentimentale, ata që do të më vënë mbi çdo njeri në jetën e tyre».

Ne duhet të arrijmë në konkluzionin që «zotëria "tepër i lehtë" e braktisi Jezusin dhe u largua me trishtim. Dëshira e tij për të qenë një dishepull u bë copë-copë mbi gurët e lidhjes familjare. Ndoshta shkaku ishte një nënë që tha duke derdhur shumë lotë «Ti do të thyesh zemrën e nënës sate n.q.s. do të më lësh për të shkuar si një misionar.». Ne nuk e dimë shkakun, por dimë që Bibla e fsheh nga mirësia emrin e këtij njeriu zemërpulë që duke u kthyer humbi mundësinë më të madhe të jetës së tij dhe fitoi këtë epitaf: «nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë».

Përmbledhje

Këto, pra, janë të tria pengesat më të mëdha kundër atyre që kanë dëshirë për të ndjekur Krishtin. Ato janë ilustruar nga tre burra të cilët nuk ishin gati për ta ndjekur Zotin Jezus Krisht deri në fund.

Zotëria "tepër i shpejtë" kishte dashurinë e gjërave tokësore.

Zotëria "tepër i ngadalshëm" kishte më shumë dashuri për punën e tij se për Krishtin.

Zotëria "tepër i lehtë" ishte penguar nga lidhjet familjare.

Megjithatë thirrja e Zotit Jezus është e përgjeshme dhe vazhdon deri tani. Ai akoma kërkon meshkuj dhe femra për ta ndjekur heroikisht dhe me sakrificë. Gjithashtu rrugëdaljet vazhdojnë të ekzistojnë dhe shfaqen me këto fjalë të ëmbla «Shpëto vetën! Largohu prej saj!»

Pak janë gati për të pranuar këtë thirrje.

Jezus, kryqin tim unë e kam marrë,

të gjithë të braktis për të të ndjekur

Jam i zhveshur, i varfër, i përbuzër, i braktisur,

por që tani e tutje ti je gjithçka për mua.

Largo nga unë çdo dëshirë të dashur:

gjithçka që kam kërkuar, kam shpresuar, ose kam njohur.,

Sa e pasur është gjendja ime,

Perëndia dhe qielli janë të mijët.

Le të më urrejë bota dhe të më braktisë bota sepse
e kanë braktisur gjithashtu Shpëtimtarin tim.
Zemrat dhe pamjet njerëzore shikime më mashtrajnë,
por Ti nuk je si ato, të rremë.
Oh, megjithëse armiq mund të më urrejnë dhe miq mund të më braktisin,
Ti më buzëqesh,
Ti Perëndi i urtësisë, dashurisë, dhe fuqisë.
Zbulo fytyrën tënde dhe gjithçka ndriçon.

- H.F. Lyte

Dishepujt janë administratorë

Lexo Lluca 16:1-13

Dishepujve iu drejtua shëmbëlltyra e administratorit të pabesë. Në këtë shëmbëlltyrë Shpëtimtari cakton parimet që u përkasin dishepujve në çfarëdo kohe. Dishepujt e Krishtit janë administratorë, d.m.th. atyre u është besuar kujdesi për zotërimet dhe interesat e Tij këtu mbi tokë.

Shëmbëlltyra përmban disa vështirësi. Duket që ajo lëvdon pandershmërinë dhe gënjeshtëri. Por kur kuptohet në dritën e përshtatshme, ka shumë mësim të rëndësishme.

Shkurt, historia është kjo. Një pasanik kishte punësuar një administrator që të kujdesej për biznesin e tij. Me kalimin e kohës, pronari mori vesh që administratori po ia bënte paratë rrush e kumbulla. Menjëherë ai i kërkoi t'i bëhej inventar librave, pastaj e lajmëroi që e kishte pushuar nga puna.

Administratori e kuptoi që perspektiva e së ardhmes së tij ishte përtokë. Ai ishte plak për të bërë punë të rëndë fizike dhe kishte turp të lypte. Prandaj ai gjeti një plan që do t'i siguronte atij miq për kohët që do të vinin. Ai shkoi te një nga ata që i kishin borxh pronarit të tij dhe i tha, "Sa i ke borxh pronarit tim?" Përgjigjja ishte, "Tremijë litra vaj." "Mirë," tha administratori, "paguaj gjysmën e shumës e do ta quajmë pazarin të mbyllur." Shkoi te një tjetër borxhli dhe i tha, "Sa borxh ke?" Klienti iu përgjigj, "Tetë qind shinikë me grurë." "Po [...] mirë, më paguaj gjashtëqind e dyzet shinike dhe e mbyllim muhabetin".

Edhe më tronditës se veprimi i këtij administratori të pabesë është komentë që vijon:

"Zotëria e lavdëroi administratorin e pandershem, se kishte vepruar me mençuri, sepse bijtë e kësaj bote në brezin e tyre janë më të mençur se bijtë e dritës" (vargu 8).

Si ta kuptojmë këtë aprovim të hapur të një pune të pandershme?

Një gjë është e qartë. As zotëria i tij, e as Zoti ynë nuk e lëvdon këtë lloj mashtrimi. Ishte kjo gjë që shkaktoi pushimin e tij nga puna në fillim. Asnjë person i drejtë nuk mund ta miratonte një pabesi e mashtrim të tillë. Çfarëdo gjëje tjetër që të mësojë kjo shëmbëlltyrë, nuk na sugjeron kurrë që përvetësimi i pasurisë së tjetrit është i justifikuar.

Shërbëtori i padrejtë mund të lavdërohet vetëm për një gjë: ai planifikoi për të ardhmen. Bëri hapa për t'u siguruar që të kishte miq edhe mbasi puna e tij të kishte mbaruar. Ai veprroi për "pastaj" në vend që të vepronte për "tani".

Kjo është pika e shëmbëlltyrës. Njerëzit e botës veprojnë me forcë të madhe për të qenë të siguruar për ditët që do të vijnë. E vetmja e ardhme për të cilën shqetësohen ata është për ditët e pleqërisë, për vitet e pensionit. Prandaj punojnë me zell e sigurohen që të jenë të rregulluar rehat kur të mos jenë më në gjendje të përballojnë punë fitimprurëse. Nuk lënë dy gurë bashkë derisa të kenë sigurim social.

Për këtë gjë, jobesimtarët janë më të zgjuar se të krishterët. Sidoqoftë, për të kuptuar pse, duhet të kuptojmë se e ardhmja e të krishterit nuk është në tokë por është në qiell. Kjo është pika kyç. E ardhmja për një jobesimtar do të thotë koha midis kohës së tanishme dhe varrit. E ardhmja, për një fëmijë të Perëndisë do të thotë përjetësi me Krishtin.

Shëmbëlltyra na mëson se ata që nuk e kanë jetën e përjetshme janë më të mençur e agresiv për të përgatitur të ardhmen e tyre mbi tokë, sesa të krishterët për të ardhmen e tyre në qiell.

Në këtë sfond, Zoti Jezus na paraqet zbatimin praktik të mësimin:

Unë, pra po ju them: Bëjini miq me pasuri të padrejta sepse kur këto t'ju mungojnë, t'ju pranojnë në banesat e përjetshme.

Pasuria e padrejtë është paraja ose gjërat e tjera materiale. Këto gjëra ne mund t'i përdorim për të fituar shpirta për Krishtin. Njerëzit e fituar nëpërmjet përdorimit tonë besnik të parave këtu quhen "miq". Do të vijë një ditë kur ne do të vdesim ose do të merremi lart në parajsë me Krishtin kur Ai të rrëmbejë Kishën. Miqtë e fituar përmes përdorimit të mençur të gjërave tona materiale, do të shërbejnë si një delegacion mirëseardhje për të na pritur në banesat e përjetshme.

Ja se si planifikojnë administratorët e mençur për të ardhmen - jo duke e harxhuar jetën e tyre të shkurtër me kërkesa të kota për siguri mbi tokë; por me përpjekje pasionante që të rrethohen në parajsë nga miq që u fituan për Krishtin me anë të parasë së tyre. Para që u kthyen në Bibla, Dhiata të Reja, pjesë nga Shkrimi, trakte dhe literaturë të krishterë. Para që u përdorën për të mbështetur misionarët dhe punëtorë të tjerë të krishterë. Para që u përdorën për të financuar programe radios të krishtera dhe aktivitete të tjera të krishtera që janë të vlefshme. Shkurt, pra, para që u përdorën për përhapjen e ungjillit me çdo mënyrë. "Mënyra e vetme për të vënë thesare në parajsë është t'i vëmë ato mbi diçka që shkon në parajsë".

Kur një i krishterë sheh që gjërat e tij materiale mund të përdoren për të shpëtuar shpirta të çmuar, ai e humb dashurinë për "gjërat". Luksi, pasuria dhe shkëlqimi material tharohen në stomakun e tij. Ai mezi pret të shohë pasuritë e padrejta të shndërrohen nga alkimia hyjnore në adhurues të Qengjit përgjithmonë. Ai ka vetëm një gjë në mendje, se si mund të punojë në jetën e njerëzve që kjo t'i sjellë lavdi të përjetshme Perëndisë dhe bekime të përjetshme vetë njerëzve. Ai ndien një etje si ajo e Rutherfordit:

Oh, sikur një shpirt prej tyre
të më takojë në të djathtë të Perëndisë
parajsa ime do bëhet dy
në tokën e Emanuelit.

-Anne R. Cousin

Për të gjithë diamantet, rubinët dhe perlat, gjithë depozitat bankare, gjithë sigurimet, gjithë vilat, jahtet dhe makinat e mrekullueshme nuk janë tjetër gjë veçse pasuri të padrejta. Në qoftë se përdoren për veten ato humbasin bashkë me përdorimin, por nëse përdoren për Krishtin ato do të korrrin interesa gjatë gjithë përjetësisë.

Mënyra se si i trajtojmë gjërat materiale, dhe se sa varem prej tyre është një provë për karakterin tonë. Zoti e thekson këtë në vargun 10:

Njeriu që është i përgjegjshëm në një gjë të vogël është i përgjegjshëm edhe në gjëra të mëdha, njeriu që është i pandershëm në një gjë shumë të vogël është i pandershëm edhe në gjëra të mëdha (William's Translation, Përkthimi William)

Këtu, gjëja e vogël është administrimi i gjërave materiale. Ata që janë të përgjegjshëm janë ata që i përdorin këto gjëra për lavdinë e Perëndisë dhe për bekimin e miqve të tyre. Ata që janë të pandershëm janë ata që i përdorin pasuritë e tyre për rehate, jetë luksoze dhe kënaqësi personale. Nëse një njeriu nuk mund t'i besohet diçka e vogël (gjërat materiale), si mund t'i lihet për administrim një gjë e madhe (gjërat shpirtërore). Në qoftë se një njeri është i pandershëm me pasuritë e padrejta, si mund të presë të jetë besnik në shërbesë për Krishtin dhe administrator i mistereve të Perëndisë (1 Kor. 4:1).

Shpëtimtari e çon argumentin edhe një hap me tej:

Pra, në qoftë se nuk keni qenë besnikë në pasuritë e padrejta, kush do t'ju besojë pasuritë e vërteta? (vargu 11)

Thesaret tokësore nuk janë pasuri të vërteta; vlera e tyre është e përkohshme dhe mbaron. Thesaret shpirtërore janë pasuri të vërteta; vlera e tyre nuk mund të matet e nuk do të mbarojë kurrë. Në qoftë se një njeri nuk është i përgjegjshëm në gjërat materiale, ai nuk mund të presë nga Perëndia që t'i besojë atij pasuri frymërore në këtë jetë ose thesare në qiell.

Përsëri Zoti e vazhdon argumentin duke thënë:

Dhe në qoftë se nuk keni qenë besnikë në pasuritë e tjetrit, kush do t'ju japë tuajën? (vargu 12)

Gjërat materiale nuk janë tonat; ato i përkasin Perëndisë. Çdo gjë që kemi është një administrim i shenjtë nga Perëndia. Ajo që mund të quhet e jona janë frutet e studimit tonë të zellshëm dhe të shërbimit tonë këtu si dhe shpërblimet e administrimit besnik atje. Në qoftë se nuk kemi treguar se jemi të përgjegjshëm me pronat e Perëndisë, atëherë nuk mund të presim të hyjmë në të vërtetat e thella të Fjalës së Perëndisë në këtë jetë ose që të shpërblehemi në tjetrën.

Duke e theksuar, Zoti atëherë e përmbledh mësimin e gjithë shëmbëlltyrës:

Asnjë shërbëtor nuk mund t'u shërbejë dy zotërinjve; sepse ose do ta urrejë njërin e tjetrin do ta dojë, ose do të lidhet me njërin e tjetrin do ta përbuzë; ju nuk mund t'i shërbeni Perëndisë dhe mamonit (vargu 13).

Nuk mund të këtë besnikëri të ndarë në dy pjesë. Një dishepull nuk mund të jetojë për dy botë. Një administrator do Perëndinë, ose mamonin. Në qoftë se do mamonin, ai urren Perëndinë.

Dhe, me falni, por kjo ju është shkruar dishepujve dhe jo të pashpëtuarve.

Zelli

Një dishepulli do t'i falej mungesa e aftësive të mëdha mendore. Gjithashtu, atij mund t'i falej edhe mungesa e manifestimit të një fuqie të jashtëzakonshme fizike. Por asnjë dishepull nuk mund të justifikohet në qoftë se ai nuk ka zell. Po qe se zemra e tij nuk është e ndezur me një pasion të zjarrtë për Shpëtimtarin, ai është i dënuar.

Mbi të gjitha të krishterët janë ndjekës të Atij që tha: «Zelli i shtëpisë sate më ka përrpirë» (Gjoni 2:17). Shpëtimtari i tyre e shkriu jetën me pasionin për Perëndinë dhe për interesat e Tij. Nuk ka vend për ndjekës që nuk dedikohen me gjithë zemër.

Zoti Jezus jetoi në një gjendje tensioni frymëror. Kjo shihet në fjalët e Tij: «Unë kam një pagëzim me të cilin duhet të pagëzohem dhe jam në ankth deri sa të kryhet» (Lluka 12:50). Si dhe nga fjalët e Tij të paharrueshme: «Unë duhet t'i kryej veprat e Atij që më ka dërguar sa është ditë; vjen nata kur askush nuk mund të veprojë» (Gjoni 9:4).

Zelli i Gjon Pagëzorit u dëshmuar nga Jezusi kur Ai tha: «Ai ishte një kandil që digjet e ndriçon» (Gjoni 5:35).

Apostulli Pal ishte plot zell. Dikush është munduar ta përshkruajë jetën e tij nëpërmjet kësaj tabloje:

«Ai është një njeri që nuk shqetësohet të bëjë miq. Ai është pa shpresë dhe pa dëshirë për të mirat e botës. Ai s'merr parasysh humbjen nga bota. Ai s'shqetësohet për jetën, dhe s'ka frikë nga vdekja. Ai është njeri pa rang, pa kombësi. Ai ka një mendim të vetëm—Ungjillin e Krishtit. Njeri me një qëllim të vetëm—lavdinë e Perëndisë. Budalla, por i kënaqur për t'u konsideruar budalla për Krishtin. Le ta quajnë entuziast, fanatik, ose me ndonjë fjalë tjetër të papërshtueshme, që bota mund të zgjedhë për ta quajtur atë. Por

së pari, le të njihet si i krishterë. Sapo ta quajnë tregtar, zot shtëpie, shtetas, i pasur, njeri i botës, njeri i librave dhe madje edhe njeri i arsyeshëm, atëherë karakteri i tij ka marrë fund. Ai ose duhet të flasë ose duhet të vdesë dhe edhe pse duhet të vdesë, ai do të flasë. Ai nuk gjen pushim, por nxiton mbi tokë e det, mbi gurë e shkretëtira pa gjurmë njeriu. Ai thërret e nuk kursehet të thërrasë, dhe nuk do të pengohet. Në burgje ai ngre zërin, dhe në stuhitë e oqeanit, ai nuk është i heshtur. Para trupave gjykues të ashpër, këshillave të tmerrshëm dhe para froneve të mbretërve, ai dëshmon të vërtetën. Asgjë nuk mund t'ia mbyllë gojën, përveçse vdekja dhe madje për sa i përket vdekjes, para se shpata t'ia ndajë kokën nga trupi, ai flet, lutet, dëshmon, pohon, kërkon, lufton dhe shtrin dorën të bekojë njerëzit e ashpër».

Edhe burra të tjerë të Perëndisë kanë shprehur të njëjtën dëshirë të zjarre për të kënaqur Perëndinë. C.T. Stud shkroi:

«Disa duan të jetojnë në tingullin
e këmbanës së kishës.
Unë dua të kem takim ungjilli
një hap para ferrit».

Rastësisht, një artikull i shkruar nga një ateist, e bëri Stadin t'i përkushtohet krejtësisht Krishtit. Në artikull thuhej:

«Po të besoja ashtu siç pohojnë miliona njerëz, se njohuria dhe praktika e fesë në këtë jetë ka të bëjë me destinacionin në një tjetër, atëherë feja do të ishte gjithçka për mua. Do t'i konsideroj mbeturina të gjitha kënaqësitë tokësore, shqetësimet tokësore si marrëzi dhe mendimet dhe ndjenjat tokësore si kotësi. Feja do të ishte mendimi i parë në mëngjes dhe imazhi i fundit në mendjen time para se gjumi të më përpinte në botën e pavetëdijes. Do të punoja vetëm për këtë kauzë. Do të mendoja vetëm për përjetësinë. Do t'ia vliente të vuaja gjithë jetën, po të fitoja një vend në parajsë. Rrethanat tokësore kurrë nuk do të më lidhnin duart apo të më qepnin buzët. Toka, me çastet e gëzueshme e të hidhërueshme të saj, nuk do të zinte vend në mendjen time. Do të mundohesha të shihja veten në Përjetësi, dhe në frymët e pavdekshme përreth meje, që shpejt do të bëheshin ose të gëzueshme përgjithmonë, ose përgjithmonë të tmerrshme. Do të shkoja kudo në botë, dhe t'i predikoja asaj pa marrë parasysh kohën, dhe mesazhi do të ishte: «Ç'PËRFITIM DO TË KISHTE NJË NJERI PO TË FITONTE TË GJITHË BOTËN DHE TË HUMBISTE FRYMËN E TIJ?»

Xhon Uesli ishte një njeri plot zell. Ai ka thënë: «Më jepni njëqind njerëz, që e duan Perëndinë me gjithë zemër dhe që nuk i frikësohen asgjëje përveçse mëkatit, dhe unë do ta lëviz botën».

Xhim Elioti, dëshmor për Zotin në Ekuador, ishte një flakë zjarri për Jezu Krishtin. Një ditë, ndërsa po meditonte në fjalët: «Ai i bën shërbenjësit e Tij flakë zjarri» (Heb. 1:7), ai shkroi në ditarin e tij:

«A jam i ndezshëm? Perëndi më çliro nga gëlqerja e pashuar e «gjërave të tjera». Më kullo me vajin e Frymës së Shenjtë, që unë të jem një flakë. Por flaka është e menjëhershme, e jetë shkurtër. O shpirti im, o jetë e shkurtër, a nuk mund ta durosh këtë? Në mua banon Fryma e Të Madhit Jetëshkurtër, zelli i të cilit për shtëpinë e Perëndisë e konsumoi Atë. «Më bëj të jem lëndë djegëse për Ty, o Flakë e Perëndisë».

Fjalja e fundit është cituar nga një poemë e zjarrtë e Ami Karmikaelit. Është pak e çuditshme që Xhim Elioti u frymëzua nga kjo poemë.

«Nga lutja që kërkon që të jem
i shtrehuar nga erërat që të godasin,
nga frika kur të aspirohem,
nga gabimet kur të ngjitëm më lart.
Nga vetja e butë, O Kapiten, çliro
Ushtarin që do të ndjekë Ty.

Nga dashuria dinake e gjërave të buta,
nga zgjedhjet e lehta, dobësitë;
se kështu shpirtrat nuk fortifikohen,
as i Kryqëzuari nuk ndoqi këtë rrugë,
nga gjithçka që e errëson Kalvarin Tënd,
O Qengj i Perëndisë më çliro.

Më jep dashurinë që më drejton në atë rrugë,
besimin që asgjë nuk mund ta shkatërrojë,
shpresën që asnjë dëshpërim të mos e dobësojë,
pasionin që të digjet si zjarri,
mos më lër të bëhem i pavlefshëm:
Më bëj lëndën Tënde djegëse, O Flakë e Perëndisë».

Fatkeqësia e kishës në shekullin e njëzetë ishte se zelli te komunistët dhe kultet e ndryshme ishte më i fortë se te të krishterët.

Në vitin 1903, një njeri me shtatëmbëdhjetë pasues filloi sulmin e tij mbi botën. Ai ishte Lenini. Më 1918, numri u rrit në dyzet mijë dhe me ata dyzet mijë ai siguroi kontroll mbi njëqind e gjashtëdhjetë milion njerëz të Rusisë. Dhe lëvizja vazhdoi dhe kontrolloi një të tretën e popullsisë së botës. Megjithatë, sado kundër parimeve të tyre të jemi, nuk mund të kalohet lehtë pa e vënë re zellin e tyre.

Shumë të krishterë u prekën shumë kur Billi Graham lexoi për herë të parë letrën e mëposhtme, të shkruar nga një student amerikan, i cili ishte bërë komunist në Meksikë. Qëllimi i shkrimit të kësaj letre ishte ti shpjegonte të fejuarës së tij shkakun e ndërprerjes së fejesës së tyre.

«Ne komunistët kemi një shkallë më të lartë fatkeqësish. Ne jemi ata që vritemi, varemi, burgosemi e keqtrajtohem dhe poshtërohemi e pushohemi nga puna, dhe në një mënyrë apo një tjetër na e bëjnë jetën sa më të vështirë që të jetë e mundur. Një përqindje e madhe prej nesh vriten ose burgosen. Ne jetojmë në varfëri virtuoze. Ne i kthejmë partisë çdo qindarkë që na tepron mbi atë që na duhet për të mbajtur frymën gjallë. Ne komunistët nuk kemi kohë dhe para për të parë filma, për koncerte, për restorante ose për shtëpi të mira apo makina të reja. Ne jemi quajtur si fanatikë. Ne jemi fanatikë. Jetët tona dominohen nga qëllimi ynë kryesor: LUFTA PËR KOMUNIZËM MBARËBOTËROR.

«Ne komunistët kemi një filozofi për jetën, të cilën as paraja nuk mund ta blejë. Ne luftojmë për një kauzë, një qëllim të përcaktuar në jetë. Ne ia nënshtrojmë veten dhe gjërat e jetës kësaj lëvizjeje të madhe për njerëzimin dhe në qoftë se jetët tona personale duken se janë të vështira, ose egoja jonë duket se vuan nga varësia te partia, ne atëherë menjëherë kompensohem nga mendimi se secili nga ne në mënyrën e tij më të vogël po kontribuon për diçka të re e të vërtetë e më të mirë për njerëzimin. Është një gjë për të cilën, jam tepër i ndershëm, dhe ajo është kauza komuniste. Ajo është jeta, biznesi, feja, gjëja e preferuar, e dashura, bashkëshortja dhe zonja, buka dhe mishi im. Punoj për të gjatë ditës dhe gjatë natës ëndërroj për të. Ndërsa koha kalon, ajo veçse zë një vend më të madh në mua. Për këtë arsye, unë nuk mund të mbaj miqësi, një marrëdhënie dashurie, madje edhe një bisedë pa i lidhur ato me këtë forcë, e cila më drejton e udhëheq në jetë.

Unë i vlerësoj njerëzit, librat, idetë dhe veprimet sipas efektit që ata kanë në kauzën komuniste dhe nga qëndrimi i tyre ndaj saj. Tashmë kam qenë edhe në burg për idetë e mia dhe nëse është e nevojshme jam gati të qëndroj edhe përpara skuadrës së pushkatimit».

Në qoftë se komunistët janë kaq të dedikuar për kauzën e tyre, atëherë të krishterët duhet ti dedikohen shumë më tepër devocionit të tyre të dashur e ngazëllyes për Zotin e tyre të lavdishëm. Sigurisht, në qoftë se Zoti Jezus është sadopak i vlefshëm, atëherë Ai është i denjë për gjithçka. «Në qoftë se besimi i krishterë është i vlefshme për të besuar në Të, atëherë ja vlen të besosh heroikisht» - Findlei.

«Në qoftë se Perëndia vërtetë ka bërë diçka në Krishtin, prej të cilit varet shpëtimi i botës, dhe në qoftë se Ai e ka bërë të njohur atë, atëherë është detyrë e të krishterëve të jemi të pa tolerueshëm ndaj gjithçkaje që e mohon, hedh poshtë ose nuk merr parasysh atë.» - Xheims Deni.

Perëndia i do njerëzit që i janë dorëzuar plotësisht kontrollit të Frymës së Shenjtë. Këta njerëz do t'u duken të tjerëve sikur janë të dehur me verë, por ata që dinë të gjykojnë më thellë do ta kuptojnë se ata janë të tillë nga «një etje e thellë, e madhe e pashtershme për Perëndinë.»

Gjithkush që do të bëhet dishepull le ta bëjë dëshirë të zemrës domosdoshmërinë e zellit në jetë. Le të ketë si aspiratë realizimin e përshkrimit të dhënë nga Arqipeshkov Ryle:

«Njeriu i zellshëm në fe është kryesisht njeriu që i përket një gjëje të vetme. Nuk është e mjaftueshme të themi se ai është i ndershëm, i përzemërt, i pakompromentueshëm, i hollësishëm, besnik, i zellshëm në frymë. Ai sheh vetëm një gjë, ai kujdeset vetëm për një gjë, ai jeton për një gjë, është përfshirë në një gjë; dhe ajo gjë e vetme është të kënaqë Perëndinë. Atij nuk i bëhet vonë nëse jeton apo vdes, nëse gëzon shëndet të mirë apo është i sëmurë, nëse është i pasur apo i varfër, nëse i kënaq njerëzit apo i ofendon ata, nëse të tjerët e konsiderojnë të mençur apo budalla, nëse e fajësojnë apo lavdërohet, nëse merr lavdi apo vihet në turp. Ai digjet vetëm për një dëshirë; dhe ajo është të kënaqë Perëndinë dhe të çojë përpara lavdinë e Perëndisë. Po të konsumohej në atë dëshirë, atij nuk i bën aspak përshtypje, por përkundrazi ai është i kënaqur. Ai e ndjen veten si një llambë, që është bërë të ndriçojë; dhe nëse digjet ndërsa ndriçon, ai ka bërë vetëm atë gjë për të cilën Perëndia e krijoi. Një njeri i tillë gjithmonë do të gjejë një fushë veprimi për të shprehur zellin e tij. Në qoftë se ai nuk mund të predikojë, të punojë ose të japë para, ai mund të ngrejë zërin në lutje. Në qoftë se ai s'është gjë tjetër veçse një i varfër, ose në shtratit e vdekjes, ai nëpërmjet lutjes do të bëjë që mëkati rreth tij të largohet shpejt. Në qoftë se ai nuk mund të luftojë në luginë me Jozueun, ai do të bëjë atë që bëri Moisiu, Aaroni dhe Huri në kodër (Eks. 17:9-13). Nëse ai vetë nuk mund të punojë, ai nuk do të reshtë së kërkuari Zotit derisa një tjetër ta ndihmojë nga një tjetër dhe puna të kryhet. Këtij i thonë zell në fe».

Besimi

Nuk mund të ketë dishepullim të vërtetë pa besim të vërtetë dhe të padiskutueshëm në Perëndinë e gjallë. Ai, që do të bëjë vepra të mëdha për Perëndinë, duhet t'i bëjë ato pa asnjë rezervë. «Të gjithë gjigantët e Perëndisë kanë qenë njerëz të dobët, të cilët kanë bërë gjëra të mëdha për Perëndinë, nga që besonin se Perëndia ishte me Ta» - Hadsën Tejlër.

Besimi i vërtetë bazohet në disa premtime të Perëndisë, në Fjalën e Tij. Kjo është e rëndësishme. Së pari, besimtari dëgjon ose lexon një premtim të Zotit. Fryma e Shenjtë e merr atë premtim dhe ia vë në

zemër e ndërgjegje në mënyrë personale. I krishteri bëhet i vetëdijshëm se Perëndia i ka folur atij në mënyrë të drejtpërdrejtë. Me siguri të madhe në besnikërinë e Atij që dha premtimin, ai tani e konsideron atë premtim si të ishte përbushur, megjithëse, nga ana njerëzore kjo është e pamundur.

Ose ndoshta kjo është një urdhëresë dhe jo një premtim. Për besimin kjo nuk duhet të përbëjë ndonjë ndryshim. Po ta japë Perëndia, Ai do ta bëjë atë të mundshme. Po qe se Ai i kërkon Pjetrit të ecë mbi ujë, Pjetri duhet të jetë i sigurt se Ai do t'i japë fuqinë e duhur për ta bërë këtë (Mat. 14:28). Në qoftë se Ai na urdhëron t'i predikojmë Ungjillin çdo krijese, ne mund të jemi të sigurt që Ai do të sigurojë hirin e duhur (Marku 16:15).

Besimi nuk vepron në sferën e të mundshmes. Nuk ka lavdi për Perëndinë në atë që është e mundshme nga ana njerëzore. Fundi i fuqisë së njeriut është fillimi i besimit. «Provinca e besimit fillon atje kur probabilitetet marrin fund dhe kur shikimi dhe ndijimi nuk është i mundur» - Xhorxh Muller.

Besimi thotë: «Në qoftë se “e pamundura” është i vetmi problem, atëherë ajo mund të bëhet!»

«Besimi sjell Perëndinë në skenë dhe si rrjedhojë nuk njih absolutisht asnjë vështirësi—në fakt, ai qesh me të pamundurën. Sipas gjykimit të besimit, Perëndia është përgjigja madhore e çdo pyetjeje—zgjidhja madhore për çdo vështirësi. Gjithçka i referohet Atij; dhe kështu nuk ka aspak rëndësi për besimin nëse janë gjashtë qind dollarë apo gjashtëdhjetë mijë dollarë; ai e di se Perëndia zotëron gjithçka. Besimi i gjen të gjitha burimet në Të. Mosbesimi thotë: «Si është e mundur që kjo e kjo të ndodhë?» Është plot «si», por besimi ka një përgjigje të madhe për dhjetë mijë «si-të?», dhe ajo përgjigjet—Perëndia» - C. H. Makintosh.

Nga ana njerëzore, do të ishte e pamundur për Abrahamin dhe Sarën të kishin fëmijë. Por Perëndia kishte premtuar dhe për Abrahamin vetëm një gjë ishte e pamundur—që Perëndia të gënjente.

«Ai duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: “Kështu do të jetë pasardhja jote”. Dhe, duke mos qenë aspak i dobët në besim, nuk i kushtoi kujdes trupit të tij, i bërë tashmë si i vdekur (ishte pothuaj njëqind vjeç) as barkut të vdekur të Sarës. Madje as nuk dyshoi nga mosbesimi në lidhje me premtimin e Perëndisë, por u përforcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që Ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte (Romakëve 4:18-21).

«Besim' i vërtet' sheh premtimet
dhe vetëm Zotin shikon;
i përqesh të pamundshmet
“Do të bëhet!” ngazëllon»

Perëndia ynë është Ai që specializohet në të pamundurën (Luka 1:37). Asgjë nuk është tepër e vështirë për Të (Zan. 18:14). «Gjëra të pamundshme për njerëzit janë të mundshme për Perëndinë» (Luka 18:27).

Besimi deklaron premtimin e Tij: «Çdo gjë është e mundshme për atë që beson» (Marku 9:23) dhe gjen përbushje në Palin: «Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon» (Fil. 4:13).

«Dyshimi sheh pengesat—
besimi sheh rrugën!
Dyshimi sheh më të errtën nat'—
besimi sheh ditën!
Dyshimi asnjë hap nuk ndërmerr—
besimi ngrihet n' lartësi.
Pyetjes s' dyshimit “Kush beson?”
“Unë!” i përgjigjet besimi.»

Besimi nuk duket se është gjithmonë «i arsyeshem», meqë besimi ka të bëjë me atë që është e

mbinatyrshme dhe hyjnore. Abrahami nuk përdori «arsyetimin» kur u largua pa e ditur se ku po shkonte, por thjesht iu bind thirrjes së Perëndisë (Heb. 11:8). Nuk ishte «e mirëmenduar» për Jozueun të sulmonte Jerikon pa mjete vdekjeprurëse (Jozueu 6:1-20). Njerëzit në këtë botë do ta përqeshnin këtë «marrëzi». Por dha rezultat!

Në fakt, besimi është më i arsyeshmi. Çfarë do të ishte më e arsyeshme se një krijesë të besonte në Krijuesin? A do të ishte marrëzi të besojë në Atë që nuk gënjen, nuk dështon apo nuk gabon? Të besosh në Perëndinë është gjëja më e mençur dhe e arsyeshme që njeriu mund të bëjë. Nuk është një lëvizje në errësirë. Besimi kërkon evidencën më të sigurt dhe ai e gjen atë në Fjalën e pagabueshme të Perëndisë. Askush nuk e ka besuar Atë më kot më parë ose në të ardhmen. Besimi në Zotin nuk përbën asnjë rrezik.

Besimi me të vërtetë përlëvdon Perëndinë; i jep Perëndisë vendin e Tij të duhur si Ai që është plotësisht i besueshëm. Nga ana tjetër, mosbesimi nuk e nderon Perëndinë; ai e bën Atë gënjeshtar (1 Gjonit 5:10). Mosbesimi e kufizon të Shenjtin e Izraelit (Psalmi 78:41).

Gjithashtu, besimi i jep njeriut vendin e tij të duhur—si një kërkues i përlulur, në gjuhë në pluhur para Zotit sovran mbi të gjithë.

Besimi është e kundërta e shikimit. Pali na kujton se «ne ecim nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet asaj që shohim» (2 Kor. 5:7). Të ecësh nëpërmjet asaj që shohim do të thotë të kesh diçka të dukshme, të kesh rezerva të mjaftueshme për të ardhmen, të përdorësh zgjuarsinë për rreziqet e padukshme. Të ecësh nëpërmjet besimit është krejt e kundërta; është mbështetje nga çasti në çast veçse në Perëndinë. Kjo është një gjendje varësie e përhershme ndaj Zotit. Mishi është në varësi të plotë ndaj Perëndisë së padukshëm. Ai kërkon të sigurojë një mbështetje ndaj humbjeve të mundshme. Po të mos e shohë se ku po shkon, ai do të vuante pasoja nervore. Por këtu ndërhyt besimi, i cili duke iu bindur Fjalës së Perëndisë, ngrihet mbi rrethanat dhe i beson Perëndisë për plotësimin e të gjitha nevojave.

Çdo dishepull, që vendos të ecë nëpërmjet besimit, duhet të jetë i sigurt se besimi i tij do të vihet në provë. Herët apo vonë, ai do të arrijë në fund të burimeve të tij njerëzore. Në këtë gjendje ekstreme, ai do të tundohet ta përqendroj vëmendjen te të tjerët. Në qoftë se ai vërtetë do të besonte në Zotin, ai do të shihnte vetëm Perëndinë.

«Të bëj të njohura dëshirat e mia, në mënyrë direkte ose indirekte te një njeri tjetër, do të thotë të largohem nga jeta e besimit dhe të mos e nderoj Perëndinë. Në fakt, është tradhti ndaj Tij. Nuk mund të them se Perëndia më ka lënë në baltë dhe kështu duhet t'u kërkoj ndihmë të tjerëve. Do të thotë të braktis burimin e gjallë dhe të shkoj te një cisternë e prishur. Do të thotë të vendos krijesën midis shpirtit dhe Perëndisë, dhe kështu të bëj të pamundur bekimin e shpirtit tim dhe lavdinë për Perëndinë» - C. H. Mackintosh.

Qëndrimi i zakonshëm i një dishepulli është të dëshirojë rritje në besim (Lluka 17:5). Ai tashmë ka besuar në Krishtin për shpëtimin e tij. Tani ai kërkon t'ia nënshtrojë aspektet e tjera të jetës së tij kontrollit të Zotit. Ndërsa gjendet përballë sëmundjeve, kohëve të vështira, tragjediave dhe mungesës së gjërave, ai arrin ta njohë Perëndinë në një mënyrë të re dhe më intime dhe kështu besimi i tij forcohet. Ai provon të vërtetën e premtimit: «Atëherë do ta dimë, në qoftë se vazhdojmë ta njohim Zotin» (Hosea 6:3). Sa më shumë të besojë se Perëndia është besnik, aq më tepër do të besojë në Të për gjëra edhe më të mëdha.

Meqë besimi vjen nëpërmjet dëgjimit dhe dëgjimi nëpërmjet Fjalës së Perëndisë, atëherë dishepulli duhet ta kullojë veten në Shkrimet e Shenjta—t'i lexojë, t'i studiojë, t'i mësojë përmendsh, të meditojë mbi to ditë e natë. Ata janë harta dhe busualla e tij, udhëzuesi dhe ngushëlluesi i tij, llamba dhe drita e tij.

Në dritën e besimit, gjithmonë ka vend për avancim përpara. Kur lexojmë se çfarë është bërë e mundur nëpërmjet besimit, ne vëmë re se jemi si fëmijë të vegjël, duke luajtur në një oqean të pafund. Veprat e besimit jepen në Hebrenjve 11. Ato ngrihen në një shkallë gjithnjë në rritje në vargjet 32-40:

«Dhe ç'të them më? Sepse nuk do të më mjaftonte koha, po të doja të tregoja për Jedeonin, Barakun, Sansonin, Jeftin, Davidin, Samuelin dhe profetët, të cilët, me anë të fesë nënshtruan mbretëri, realizuan drejtësinë, arritën ato që u premtuan, ua zunë grykën luanëve, fikën fuqinë e zjarrit, shpëtuan nga tehu i shpatës, nga të dobëtët u bënë të

fuqishëm, u bënë të fortë në betejë, thyen ushtritë e huaja. Gratë morën të vdekurit e tyre me anë të ringjalljes; e të tjerët u torturuan, sepse nuk pranuan çlirimin, për të fituar një ringjallje më të mirë. Dhe të tjerë përjetuan përqeshje dhe goditje, madje edhe pranga dhe burgime. U vranë me gurë, me sharrë, u prenë, u vranë nga shpata, u endën të mbuluar me lëkurë dhensh e dhish, nevojtarë, të pikëlluar, të keqtrajtuar (bota nuk ishte e denjë për ta), u sollën nëpër shkretëtira e nëpër male, nëpër shpella dhe nëpër guvat e dheut. E pra, të gjithë këta, ndonëse morën dëshim të mirë me anë të besimit, nuk morën atë që u ishte premtuar, sepse Perëndia kishte paraparë diçka më të mirë për ne, që ata të mos arrinin në përsosje pa ne».

Një fjalë e fundit! Tashmë ne kemi përmendur se një dishepull që ecën nëpërmjet besimit padyshim do të konsiderohet ëndërrimtar ose fanatik nga njerëzit në këtë botë dhe madje edhe të krishterë të tjerë. Por është mirë të kemi parasysh se «besimi që bën të mundur “ecjen me Perëndinë”, gjithashtu e bën të mundur që ai t’u bashkëngjit vlerat e duhura mendimeve të njerëzve» - C. H. Mackintosh.

Lutja

Bibla është i vetmi libër i plotë për sa i përket temës së lutjes. Të gjithë të tjerët na lënë me një ndjenjë se ka thellësi të pacekura dhe lartësi të pa arritura. Në këtë broshurë, ne nuk mund të shpresojmë të përmirësojmë përpjekjet e të tjerëve. Gjithçka që mund të bëjmë është të bëjmë një përmbledhje të parimeve më të rëndësishme të lutjes, veçanërisht meqë kanë të bëjnë me temën e dishepullimit të krishterë.

1. Lutja më e mirë vjen nga nevoja e fortë e brendshme. Ne të gjithë e kemi parë se kjo është e vërtetë. Kur jetët tona janë të patrazuara dhe të qeta, lutjet tentojnë të jenë jo të mprehta dhe të pakta në numër. Kur ndeshemi me një krizë, një çast rreziku, një sëmundje serioze ose një humbje, atëherë lutjet gjallërohen dhe bëhen të mprehta. Dikush ka thënë se «në mënyrë që shigjeta të godasë qiellin, ajo duhet të gjuhet nga një hark i përkulur plotësisht». Urgjencat, rastet e paaftësisë, rastet e një nevojë të madhe janë burimi i lutjeve të fuqishme.

Fatkeqësisht, ne e kalojmë shumicën e jetës duke u munduar t’u shmangemi nevojave. Nëpërmjet metodave të biznesit, ne sigurojmë rezerva të rehatshme ndaj çdo pengese. Nëpërmjet zgjuarsisë së njerëzve, ne arrijmë fazën ku jemi të pasur dhe nuk na mungon asgjë. Atëherë fillojmë të përpiqemi të kuptojmë pse jeta e lutjes është aq e cekët dhe e pagjallëruar dhe pse nuk po bie zjarr nga qielli. Po të ecim vërtet me anë të besimit dhe jo nëpërmjet asaj që shikojmë, atëherë jeta jonë e lutjes do të gjallërohej.

2. Një nga kushtet për një lutje të suksesshme është të «afrohemi me zemër të vërtetë» (Hebrenjve 10:22). Kjo do të thotë se duhet të jemi të vërtetë dhe të sinqertë para Zotit. Nuk duhet të jemi hipokritë. Po ta plotësonim këtë kusht, atëherë ne kurrë nuk do t’i kërkonim Perëndisë të bënte diçka, atëherë kur ne mund ta bëjmë atë. Për shembull, nuk do t’i kërkonim Atij të siguronte një sasi të caktuar të hollash për një projekt të krishterë ndërkohë kur kemi fonde të tepërta, të cilat mund të përdorëshin në këtë mënyrë. Nuk mund ta ngacmojmë Perëndinë. Ai nuk u përgjigjet lutjeve, atëherë kur Ai na e ka dhënë tashmë përgjigjen dhe ne nuk duam ta përdorim.

Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se nuk kemi dëshirë të shkojmë vetë, atëherë ne nuk duhet të lutemi që Zoti të dërgojë të tjerë në shërbimin e Tij. Me mijëra lutje drejtohen për muslimanët, hinduistët dhe budistët. Por në qoftë se të gjithë ata që luten do të kishin dëshirë të përdorëshin nga Zoti në deklarimin e Ungjillit të këta njerëz, atëherë historia e misionëve të krishterë do të ishte më inkurajuese.

3. Lutja duhet të jetë e thjeshtë, me besim dhe të mos vihet në pyetje. Është e lehtë të përfshihesh në problemet teologjike të lidhura me lutjen. Kjo shërben vetëm për të na dëmtuar frymërisht. Është më mirë të lutemi sesa të zgjidhim të gjitha misteret që kanë të bëjnë me lutjen. Docentët e teologjisë le të merren me trajtimin e teorive të tyre në lidhje me lutjen. Por besimtari i thjeshtë le të godasë si stuhi portat e qiellit me besim si ai i fëmijës. Ishte Agustini ai që tha: «të pashkolluarit e pushtojnë qiellin nëpërmjet forcës dhe ne me gjithë edukimin tonë as që ngrihemi mbi mishin dhe gjakun».

Nuk e di me ç"metoda rrallë,
Po këtë e di - Zoti u përgjigjet lutjeve.

Nuk e di kur Ai e dërgon fjalën,
Po kjo na tregon se Ai lutjen e dëgjon.

E di se Ai përgjigjet herët a vonë,
Kështu lutemi e t'presim gjithmon'.

S'e di se nëse bekimi i kërkuar,
Do t'vijë do të vijë në formë që kam menduar.

Ia lë lutjet vetëm Atij,
Më të zgjuarit vullnet t'Tij.
--Lola C. Henson

4. Për fuqi të vërtetë në lutje, mos kurseni asgjë. Dorëzohuni tërësisht Krishtit. Jepuni i tëri pas Tij. Braktisni gjithçka për të ndjekur Shpëtimtarin. Ai nderon atë lloj devocioni që e kurorëzon Krishtin Zot mbi të gjithë.

5. Duket sikur Perëndia e vlerëson në mënyrë të veçantë lutjen kur ajo na kushton diçka. Ata që ngrihen herët në mëngjes shijojnë bashkësinë me Atë, i cili në të njëjtën mënyrë u ngrit herët në mëngjes për të marrë udhëzimet nga Ati i Tij. Në të njëjtën mënyrë, ata që luten gjatë gjithë natës përjetojnë një fuqi të madhe me Perëndinë, gjë që nuk mund të mohohet. Lutja që nuk kushton asgjë nuk ka aspak vlerë; është rrjedhojë e krishterimit me çmim të lirë.

Shpeshherë Dhiata e Re e lidh lutjen me agjërimin. Qëndrimi pa ushqim mund të shërbejë për mirë në ushtrimet frymërore. Nga ana njerëzore, ajo ndikon në qartësi, përqendrim dhe mprehtësi. Nga ana hyjnore, duket sikur Zoti dëshiron t'u përgjigjet lutjeve kur ne e vëmë lutjen para nevojave për ushqim.

6. Evitoni lutjet egoiste. «Ju kërkoni dhe nuk merrni, sepse kërkoni keqas që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja» (Jakobi 4:3). Prioriteti i lutjeve tona duhet t'i kushtohet interesave të Zotit. Së pari, ne duhet të lutemi: «Ardhtë mbretëria Jote; u bëftë vullneti Yt në tokë ashtu si në qiell». Pastaj mund të shtojmë: «Na e jep sot bukën e përditshme».

7. Ne duhet ta nderojmë Perëndinë me kërkesa madhështore, sepse Ai është një Perëndi i madh. «Le të kemi besim për të pritur gjëra të mëdha nga Perëndia».

Ti po vjen te një Mbret,
Kërkesa të mëdha me ty sjell
Se dashuri e fuqi e Tij të tilla jan'
Saqë kurrë s'është tepër shumë'.
- Gjon Njuton

Sa herë e kemi hidhëruar Perëndinë duke pritur kaq pak nga Ai. Ne jemi kënaqur me të tilla fitore të pamjaftueshme, me arritje të varfra, me dëshira të dobëta pas gjërash më të larta, saqë nuk u kemi lënë përshtypje atyre përreth nesh se Perëndia ynë është i madh. Ne nuk e kemi përlëvduar Atë në sytë e njerëzve, që nuk e njohin Atë me jetën që u tërheq vëmendje dhe u ngre kuriozitet të krahasuar me fuqinë me të cilën janë ushqyer. Shpesh nuk na është thënë, si për apostullin: «Ata përlëvduan Perëndinë për shkakun tim» - E. U. Moor.

8. Kur lutemi, së pari ne duhet të sigurohemi se jemi në vullnetin e Perëndisë. Pastaj, duhet të lutemi, duke besuar se Perëndia do ta dëgjojë dhe do t'i përgjigjet lutjes tonë. «Kjo është siguria që kemi përpara Tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të Tij, Ai na e plotëson: Dhe nëse dimë se Ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam Atij» (1 Gjo. 5:14, 15).

Të lutesh në Emrin e Zotit Jezus do të thotë të lutesh sipas vullnetit të Tij. Kur vërtetë lutemi në Emrin e Tij, është tamam si Ai Vetë t'i kërkonte Perëndisë, Atit të Tij për ne. «Dhe çfarëdo të kërkonte në Emrin Tim, do ta bëj, që Ati të përlevdohet në Birin. Në qoftë se do të kërkonte diçka në Emrin Tim, Unë do ta bëj» (Gjoni 14:13,14). «Atë ditë ju nuk do të më bëni asnjë pyetje. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se çdo gjë që t'i kërkonte Atit në Emrin Tim, Ai do t'ju japë» (Gjoni 16:23). «Po ju them gjithashtu se, në qoftë se dy prej jush bien në ujdi mbi tokë të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t'u jepet atyre nga Ati Im që është në qiej. Sepse, kudo që dy a tre janë bashkuar në Emrin Tim, Unë jam në mes të tyre» (Mateu 18:19, 20).

«Të kërkojë "Në Emrin e Tij", do të thotë që Ai të të marrë për dorë dhe të jesh në lutje; do të thotë, më lejoni të them, që Ai të jetë në gjunjë pranë nesh ndërkohë që dëshirat e Tij rrjedhin në zemrën tonë. Ky është kuptimi i fjalëve «në Emrin e Tij.» Emri i Tij është çfarë Ai dhe natyra e Tij është, dhe kështu të lutemi në Emrin e Krishtit do të thotë të lutemi sipas vullnetit të Tij. A mund të lutem për ligësi në Emrin e Birit të Perëndisë? Ajo për të cilën lutem duhet të jetë shprehje e natyrës së Tij. A mund ta bëj një gjë të tillë në lutje? Lutja duhet të jetë shprehje e fuqisë së Frymës së Shenjtë, mendja e Krishtit dhe dëshirat e Tij në ne dhe për ne. Zoti na mësoftë gjithnjë e më tepër si të lutemi në Emrin e Tij. Nuk duhet të mendojmë ta mbyllim një lutje, pa përmendur fjalët: "Në Emrin e bekuar të Zotit tonë", por pastaj e gjithë lutja duhet të përshkohet nga Emri i bekuar i Jezusit--gjithçka sipas atij Emri» - Samuel Ridout.

9. N.q.s. duam që lutja jonë të jetë vërtetë efektive, ne duhet t'i qëndrojmë besnikë Perëndisë. Me këtë, nënkuptojmë se duhet të rrëfejme dhe të braktisim mëkatin porsa të bëhemi të ndërgjegjshëm për praninë e tij në jetën tonë. «Po ta kisha ruajtur të keqen në zemrën time, Zoti nuk do të më kishte dëgjuar» (Psalmi 66:18). Ne duhet të qëndrojmë në Krishtin. «Në qoftë se qëndroni në Mua dhe fjalët e Mia qëndrojnë në ju, kërkonte çfarë të doni dhe do t'ju bëhet» (Gjoni 15:7). Ai që qëndron në Krishtin, qëndron kaq afër Tij, saqë është plotësisht i vetëdijshëm për vullnetin e Zotit. Kështu ai mund të lutet drejt dhe mund të jetë i sigurt për përgjigjet e lutjeve. Theksojmë përsëri se jeta në Të kërkon që ne të zbatojmë urdhërimet e Tij. «Dhe ç'të kërkojmë, e marrim nga Ai, sepse zbatojmë urdhërimet e Tij dhe bëjmë gjërat që janë të pëlqyera prej Tij» (1 Gjonit 3:22). Është e nevojshme që shpirti të jetë në gjendjen e përshtatshme që lutjet tona të dëgjohen dhe të marrim përgjigje (1 Gjonit 3:20).

10. Ne nuk duhet të lutemi vetëm në kohë të caktuara të ditës; ne duhet të zhvillojmë një sjellje lutjeje, që të shikojmë te Zoti ndërsa ecim në rrugë, ndërsa udhëtojmë me makinë, ndërsa punojmë në tavolinë ose shërbejmë në shtëpi. Nehemia është një shembull klasik i këtij tipi lutjeje spontane (Nehemia 2:4b). Është më mirë të «banosh në vendin sekret të Më të Lartit» sesa veçse të bësh vizita të rralla atje.

11. Së fundi, lutjet tona duhet të jenë specifike. Ndodh vetëm atëherë kur ne lutemi për gjëra të përcaktuara që marrim përgjigje të përcaktuara.

Lutja është një privilegj i mrekullueshëm. Nëpërmjet këtij mjeti, ashtu siç ka thënë Hadsën Tejlëri, ne mësojmë si të lëvizim njeriun me anë të Perëndisë. «Çfarë shërbimesh janë në duart tona për mrekulli në sferën e mahnitshme të lutjes! Ne mund të sjellim rreze dielli në vende të ftohta e të hidhëruara. Ne mund të ndezim dritën e shpresës në burgun e dëshpërimit. Ne mund të këpusim zinxhirët nga këmbët e të burgosurit. Ne mund të marrim pamje e mendime nga shtëpia në atë vend të largët. Ne mund të mbartim respekt qiellor për të dobëtit frymërisht, megjithëse ata punojnë përtej deteve. Mrekulli në sajë të lutjes!» - J.H. Jouet.

Kësaj, një shkrimtar i quajtur Uenham i shton dëshminë e tij: «Predikimi është një dhunti e rrallë; lutja është një dhunti akoma më e rrallë. Predikimi, si një shpatë, është një mjet lufte për t'u përdorur në afërsi; ata që janë larg nuk mund të arrihen me të. Lutja, si një top lufte, ka zonë veprimi më të gjerë dhe në disa raste është më efektive».

Zot, ç'ndryshim brenda nesh në një orë
E kaluar në praninë Tënde do të sjellë,
Ç'mundime të mëdha nga shpina do t'na heqë,
Si toka pa ujë kur bie shi!
Ndërsa n'gjunjë, gjithçka rreth nesh duket të bjerë,

Ngrihemi, dhe e gjithçka larg e afër
e guximshme dhe e qartë qëndron në diell;
Sa të dobët, ndërsa n'gjunjë! Plot fuqi kur ngrihemi!
Atëherë, pse t'ia bëjmë vetes këtë gabim,
ose të tjerëve, se jo gjithmon' s'jemi t'fortë,
Se s'jemi gjithmon' plot kujdes,
Se kurr' s'duhet të jemi të dobët ose zemërdobët,
Të shqetësuar apo t'trazuar, kur lutja është me ne,
Dhe gëzim, e fuqi, e guximi jan' me Ty?» - Trenç

Beteja frymërore

Është pothuajse e pamundur për dikë, që zakonisht e lexon Dhiatën e Re, të mos e kuptojë se përshkrimi i betejës frymërore shpeshherë përdoret për të përshkruar programin e Krishtit në tokë. Krishterimi i vërtetë është tepër larg nga zbatimet e pafundme të krishterimit modern. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me jetesën në luks dhe në plotësimin e kënaqësive, të cilat janë kaq të zakonshme në ditët tona. Për më tepër, kjo është një betejë vdekjeje, një konflikt i pashuar kundër forcave të ferrit. Asnjë dishepull nuk është ndopak i vlefshëm, në qoftë se ai nuk e kupton se beteja ka filluar dhe se nuk ka rrugë kthimi prapa.

Në luftë duhet të ketë unitet. Nuk ka vend për ngatërresa, për xhelozë, për përçarje. Asnjë shtëpi e ndarë nga përbrenda nuk mund të qëndrojë. Kështu, ushtarët e Krishtit duhet të jenë në unitet. Udha për unitet është nëpërmjet përruljes. Kjo na bëhet e qartë në Filipianëve 2. Është e pamundur të kemi grindje me një njeri vërtetë të përrulur. Nevojiten dy veta për të filluar një ngatërresë. «Vetëm nëpërmjet krenarisë vjen grindja». Atje ku nuk ka krenari, nuk ka vend për grindje.

Lufta kërkon mungesë pretekstesh dhe një jetë me sakrifikime. Në luftë çfarëdo qofshin pasojat ekziston një sistem i gjerë kursimi. Tani është koha kur të krishterët të kuptojnë se ne jemi në luftë dhe se shpenzimet duhet të ulen në minimum me qëllim që sa më shumë burime të hidhen në betejë.

Jo gjithkush e sheh këtë siç e pa dishepulli i ri R. M. Në vitin 1960, ai ishte president i klasës së vitit të parë në një shkollë të krishterë. Gjatë kohës si president, ai duhej të shpenzonte nga fondi i aktiviteteve vetëm për mbremjet e zakonshme të klasës, për kostumet dhe një dhuratë për klasën. Në vend që t'i ulte këto shpenzime, të cilat nuk kontribonin në përhapjen e Ungjillit, R. M. dha dorëheqjen si president i klasës. Ditën e dhënies së dorëheqjes, ai u shpërndau letrën e mëposhtme shokëve të klasës:

«Të dashur shokë të klasës:

Meqë çështjet e mbremjeve të klasës, kostumeve dhe dhuratave janë shtruar para kabinetit, unë, si president i klasës kam marrë parasysh qëndrimin e krishterë ndaj këtyre çështjeve.

«Mendoj se do të gjenim gëzimin më të madh në dhënien e vetvetes, dhënien e parave dhe të kohës tërësisht Krishtit dhe të tjerëve, kështu duke e gjetur realitetin në Fjalët e Tij: "Ai që e humbet jetën e tij për Mua do ta gjejë atë».

«Që të krishterët të shpenzojnë paratë dhe kohën në gjëra që nuk rezultojnë në një dëshmi të vërtetë për jobesimtarët ose për ndërtimin e fëmijëve të Tij në Të, do të ishte e papranueshme në një kohë kur 7000 njerëz vdesin çdo ditë nga uria dhe ndërkohë kur gjysma e botës nuk ka dëgjuar për Shpresën e vetme të njeriut.

«Në vend që të mblidhemi së bashku në klikat tona, duke e kufizuar mjedisin me ato të një mendimi dhe kështu të shpërdorojmë para dhe kohë për kënaqësinë tonë, sa lavdi do t'i jepnim Perëndisë nëpërmjet ndihmës sonë për të përhapur Ungjillin në 60% të botës që nuk ka dëgjuar ndonjëherë për Jezus Krishtin ose madje në shumë shtëpi të lagjes.

«Meqë jam i vetëdijshëm për nevojat specifike dhe mundësitë për shpenzimin e burimeve financiare për përparimin e lavdisë së Jezu Krishtit dhe për ndihmën e fqinjit tonë këtu dhe jashtë, është e pamundur për mua të lejoj që fondet e klasës të përdoren pa pasur nevojë për veten tonë. Po të isha në nevojë të madhe si disa për të cilët kam dijeni, do të doja që ata që kanë mundësi të bënin gjithçka të mundshme të më plotësonin nevojat me Ungjillin dhe me nevojat materiale.

«Siç do të donit që njerëzit t'u bënin juve, ashtu bëjuni atyre».

«Dhe nëse njëri ka të mirat e kësaj bote dhe sheh të vëllanë që është në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?»

«Kështu, është me dashuri dhe lutje, që ju ta shihni Zotin Jezus duke ia dhënë Atij të gjithën (2 Kor. 8:9), që unë jap dorëheqjen si president i klasës '63.

Në Të me ju, R. M.

Lufta kërkon vuajtje. Në qoftë se të rinjtë sot janë gati të japin jetën për vendin e tyre, atëherë sa janë gati të krishterët të japin jetën për hirin e Krishtit e të Ungjillit? Besimi që nuk të kushton asgjë nuk është besim. Po qe se Zoti Jezus është diçka për ne, Ai duhet të jetë gjithçka për ne, dhe asgjë nuk duhet të na shmangë nga shërbimi për Zotin.

Kur Pali mbrojti pozitën e tij si apostull ndaj sulmeve të kritikëve të tij, ai nuk u mbështet në prejardhjen e familjes së tij, arsimimin apo arritjet e tij në këtë botë. Për më tepër, ai tregoi për vuajtjet e tij për hir të Zotit Jezus Krisht. «Ata janë shërbëtorë të Krishtit? Po flas si i pamend, unë jam edhe më tepër se këta; në mundime më tepër, në goditje më tepër, në burgje më tepër dhe shpesh në rrezik për vdekje. Nga judenjtë mora pesë herë nga dyzetë kamxhikë pa një. Tri herë më rrahën me shkopinj, një herë më qëlluan me gurë, tri herë m'u mbyti anija në det, kalova një ditë e një natë në humnerë. Në udhëtime të shpeshta në rreziqe lumenjsh, në rreziqe kusarësh, në rrezik nga ana e bashkatdhetarëve, rreziqe nga ana johebrenjve, rreziqe në qytet, rreziqe në shkretëtirë, rreziqe në det, rreziqe midis vëllezërve të rremë, në lodhje e në mundim, në netët pa gjumë, në uri e në etje, shpeshherë në agjërime, në të ftohtë dhe në të zhveshur. Përveç këtyre gjërave të jashtme, ajo që më mundon çdo ditë është kujdesja për të gjitha kishat» (2 Kor. 11:23-28).

Në thirrjen fisnike që Pali i bënte Timoteut, ai kërkon me të madhe: «Ti, pra, duro pjesën tënde të vuajtjeve, si një ushtar i mirë i Jezu Krishtit» (2 Timoteut 2:3).

Lufta kërkon bindje të plotë. Një ushtar i vërtetë ndjek urdhrat e eprorit të tij pa pyetje dhe pa hezitim. As që mund ta marrim me mend se Krishti do të kënaqej me më pak. Si Krijues dhe Shpengues, Ai ka çdo të drejtë të kërkojë nga ata që e ndjekin Atë që të zbatojnë urdhrat e Tij pa hezitim dhe plotësisht.

Lufta kërkon mjeshtëri në përdorimin e mjeteve të luftës. Mjetet e luftës për një të krishterë janë lutja dhe Fjala e Perëndisë. Ai duhet t'i përkushtohet lutjes pa pushim dhe plot besim. Vetëm atëherë mund të mposhten kështjellat e armikut. Atëherë, ai gjithashtu duhet të jetë i stërvitur në përdorimin e shtatës së Frymës, Fjalën e Perëndisë. Armiku do të bëjë ç'është e mundur që ai ta lëshojë këtë shtatë. Ai do të sjellë dyshime për origjinën hyjnore të Shkrimeve të Shenjta. Ai do të sjellë të ashtuquajtura kontradikta. Ai do të sjellë argumente kundërshtuese nga shkencat, filozofia dhe traditat e njerëzve. Por ushtari i Krishtit duhet ta tregojë veten, duke e provuar efektshmërinë e armës së tij në çdo rrethanë.

Mjetet e luftës së të krishterit duken se janë të kota për njerëzit e kësaj bote. Sot ushtarakët do ta konsideronin marrëzi planin e përdorur për pushtimin e Jerikos. Ushtria e parëndësishme e Gedeonit do të sillte vetëm marrëzi. E po për gurëdhësen (hobenë) e Davidit, për Shamgarin me shkopin e qeve, dhe ushtrinë e paarmatosur të Perëndisë në shekuj? Mendja frymërore e di se Perëndia nuk është në anën e batalioneve të mëdha, por për më tepër, Ai sjell te Vetja të dobëtit, të varfrit dhe gjërat e hedhura poshtë dhe përlëvdon Vetën nëpërmjet tyre.

Lufta kërkon të kemi njohuri për armikun dhe strategjinë e tij. Kështu është në betejën frymërore të krishterë. «Sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sunduesve të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrashta në vendet qiellore» (Efesianëve 6:12). Ne e dimë se «Satani vetë shndërrohet në engjell drite. Nuk është, pra, gjë e

madhe, nëse edhe punëtorët e tij shndërrohen në punëtorë (marrin trajtën e punëtorëve) të drejtësisë, fundi i të cilëve do të jetë sipas veprave të tyre» (2 Korintasve 11:14, 15). Një ushtar i krishterë i stërvitur e di se kundërshtimi më i madh nuk do të vijë nga një i dehur ose një vjedhës, ose një prostitutë, por nga të ashtuquajturit shërbëtorë të fesë. Ishin drejtuesit e fesë ata që e kryqëzuan Krishtin e Perëndisë. Ishin drejtuesit e fesë ata që e përdoqën kishën e hershme. Pali pësoi më tepër vuajtje në ato vende nga të ashtuquajtur shërbëtorë të Perëndisë. Dhe kështu gjatë shekujve me radhë. Shërbëtorët e djallit janë kthyer në shërbëtorë të drejtësisë. Ata flasin në gjuhë fetare, veshin rroba fetare dhe veprojnë si fetarë, por zemrat e tyre janë plot urrejtje për Krishtin dhe Ungjillin.

Lufta nuk do ngatërresa. «Sepse asnjë nga ata që shkojnë ushtarë nuk ngatërrohet me punërat e jetës, që t'i pëlqejë atij që e mori ushtar» (2 Tim. 2:4). Dishepulli i Krishtit mëson të mos tolerojë çdo gjë që hyn midis shpirtit dhe devocionit të tij ndaj Zotit Jezus Krisht. Ai është i patolerueshëm por jo ofendues, i vendosur por jo i parespektueshëm. Ai ka veçse një pasion. Gjithçka tjetër duhet të nënshtrohet.

Lufta kërkon guxim në kohë rreziku. «Prandaj merrni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund të rezistoni në ditën e mbrapshtë dhe të mbeteni më këmbë pasi të keni kryer çdo gjë. Qëndroni, pra...» (Efe. 6:13, 14). Në Efesianëve 6:13-18 thuhet se armatimi i ushtarit të krishterë nuk lë vend për kthim mbrapsht. Pse të kthehemi? Në qoftë se jemi «më shumë se fitimtarë me Atë që na deshi», në qoftë se askush nuk mund të arrijë sukses kundër nesh ngaqë Perëndia është me ne, në qoftë se e dimë se do fitojmë që para se të fillojmë betejën, atëherë si mund të në na shkojë në mendje të kthehemi mbrapsht?

»Megjith' se qëndroj me fitimtarët,
Ose humbas me ata që bien?
Të dob'tit janë mëkatarët,
Beteja është e gjitha.
I fortë armiku që përparon,
Gati është shpata ime, O Zot;
Shih flamujt e heshtat ku krenon—
Por një pjesë të shpatës më shpëto.»

--citurar nga Emi Karmikael

Sundim botëror

Perëndia na ka thirrur për sundim botëror. Ai nuk na ka krijuar të «lindim njeri e të vdesim si shitës». Qëllimi i Tij nuk është që ta kalojmë jetën në «firma të vogla si zyrtarë të vegjël».

Fillimisht kur Zoti e krijoi njeriun, Ai i dha atij sundim mbi gjithë tokën. Ai e kurorëzoi atë me lavdi dhe nder dhe i vuri të gjitha gjërat nën sundimin e tij. Njeriut iu dha dinjitet dhe sovranitet—veçse shumë pak më ulët se ai i engjëjve.

Kur Adami mëkatoi, ai humbi shumë nga sundimi i tij që i ishte dhënë hyjnisht. Në vend të sundimit me pushtet të plotë, ai sundoi i paqëndrueshëm në një sferë të pasigurtë.

Me Ungjillin, në një farë mënyre ne mund të rifitojmë sundimin. Nuk bëhet fjalë për kontroll mbi qentë e tërbuar ose gjarpërinjtë helmues, por, për më tepër bëhet fjalë për të bërë paganët trashëgimi tonën dhe pjesët më të largëta të botës pasuri tonën. «Imperializmi i vërtetë është perandoria nëpërmjet sovranitetit moral dhe frymëror; tërheqja e vëmendjes dhe sundimi nëpërmjet shkëlqimit mahnitës të një jete të kulluar e të shenjtëruar» –J.H. Jouet.

Në fakt, ky dinjitet i thirrjes së krishterë është diçka për të cilën Adami nuk kishte dijeni. Ne jemi partnerë me Perëndinë në shpengimin e botës. «Ja qëllimi ynë—të vajosim njerëzit në Emrin e Zotit për jetë mbretërore, për sovranitet mbi vetveten, për shërbim» –Dinsdeill T. Jang.

Sot tragjedia më e madhe e jetës është pakënaqësia me thirrjen. Ne kënaqemi duke kaluar vite me radhë «duke përqaftuar vogëlsitë» ose «duke studiuar kotësitë». Ne zvarritemi në vend që të fluturojmë. Jemi skllëvër në vend që të jemi mbretër. Vetëm disa kanë një vizion për konvertimin e kombeve të ndryshme për

Krishtin.

Spërxbën përbën një përjashtim. Ai i shkroi djalit të tij mesazhin e mëposhtëm:

«Unë nuk do të doja të vdisje milioner, në qoftë se Perëndia do të donte që të ishe misionar.

«Unë nuk do të gëzohesha të flisje te një mbret, po të ishe përgatitur të ishe misionar.

«Çfarë janë mbretërit, e gjithë fisnikëria, të gjitha kurorëzimet e tyre kur i mbledh të gjithë këta së bashku, të krahasuara me dinjitetin e fitimit të frymëve për Krishtin, me nderin e veçantë të ndërtimit për Krishtin, dhe jo në themelin e dikujt tjetër, por të predikosh Ungjillin në vendet e largëta?»

Një përjashtim tjetër është Gjon Mot, qeveritar misionar i njohur. Kur Presidenti Kulixh i kërkoi të shkonte si ambasador në Japoni, ai u përgjigj: «Zoti president, meqë Perëndia më ka thirrur të jem ambasador i Tij, veshët e mi nuk reagojnë ndaj ndonjë thirrje tjetër».

Billi Graham tregon për një tjetër. «Kur Firma Naftënxjerrëse Standard (Standard Oil Company) po kërkonte për një përfaqësues në Lindjen e Largët, ata zgjodhën një misionar. Ata i ofruan atij 10 mijë dollarë, por ai nuk e pranoi detyrën; 25 mijë, por nuk pranoi; 50 mijë por nuk pranoi. Pastaj ata e pyetën: «Ku qëndron problemi»? Ai u përgjigj: «Pagesa juaj është e mirë, por detyra është tepër e vogël. Perëndia më ka thirrur të jem misionar».

Thirrja e krishterë është më fisnikja e të gjithave dhe në qoftë se e kuptojmë këtë, atëherë jeta jonë do të marrë një drejtim tjetër. Nuk do të flasim më për veten tonë se «jam thirrur të jem hidraulik» ose «jam thirrur të jem doktor» ose «jam thirrur të jem dentist.» Për më tepër, duhet ta shohim veten «të thirrur për t'u bërë apostull»—dhe të gjitha këto gjëra të tjera si mjete të thjeshta për jetesë.

Ne do ta shohim veten të thirrur për t'i predikuar Ungjillin çdo krijese, dhe të bëjmë dishepuj nga të gjitha kombet, për të ungjillëzuar botën.

Detyrë e madhe, mund të thoni. Ashtu është, por nuk është e pamundur. Madhësia e kësaj detyre shihet në përshkrimin grafik të mëposhtëm të botës:

«Në qoftë se në imagjinatën tonë, ne do ta kompresonim popullsinë e sotme të botës – tani afërsisht 3 miliard njerëz (në vitin e shtypshkrimit origjinal) - në një grup një mijë vetësh që jetojnë në një qytet të vetëm, atëherë do të shihnim qartë përshkrimin e mëposhtëm.

«Gjashtëdhjetë njerëz do të përfaqësonin popullsinë e Shteteve të Bashkuara; të gjithë të tjerët do të përfaqësoheshin nga 940. 60 amerikanët do të kishin 35% të të ardhurave të të gjithë qytetit; dhe 940 të tjerët do të ndanin 65% të pjesës që mbetet.

«Tridhjetë e gjashtë nga amerikanët në atë qytet do të pohonin të ishin anëtarë (të ashtuquajtur) të kishës së krishterë; dhe njëzet e katër jo. Në gjithë qytetin, rreth 290 do të pohonin të ishin të krishterë dhe 710 jo. Të paktën 80 veta do të ishin komunistë dhe 370 do të ishin nën sundimin komunist. Ndoshta 70 nga i gjithë qyteti do të pohonin të ishin të krishterë protestantë (të ashtuquajtur).

«Treqind e tre veta në të gjithë qytetin do të ishin të bardhë; 697 jo të bardhë. 60 amerikanët do kishin jetëgjatësi mesatare 70 vjeç; të gjithë të 940 vetat e tjerë mesatarisht 40 vjeç.

«Amerikanët do të zotëronin 15.5 herë më shumë pasuri për person në krahasim me mesataren e pjesës tjetër. Ata do të prodhonin 16% të furnizimit ushqimor të të gjithë ushqimit të qytetit, të shpenzonin 1.5% të pasurisë totale ushqimore dhe të ruanin pjesën tjetër për të ardhmen në magazina të shtrenjta. Kur kujtojmë se 940 jo-amerikanët në qytet gjithmonë do të kishin uri dhe nuk do të dinin se kur të kishin mjaft për të ngrënë, situata e krijuar nga ky kontrast në ushqim dhe rezervat bëhet mjaft i dukshëm, veçanërisht

në sajë të faktit se tashmë amerikanët konsumojnë 72% më shumë se kërkesat optimale për ushqim. Në fakt, ata do të kursenin para nëpërmjet shpërndarjes së ushqimit të tepërt për arsye të kostos së lartë për magazinim, por ata mendojnë se kjo do të ishte «një program mirëbërës me rrezik».

«Në krahasim me të tjerët, gjashtëdhjetë amerikanët do të kishin 12 herë më shumë se gjithë të tjerët energji elektrike, 22 herë më shumë qymyr, 21 herë më shumë karburante, 50 herë më shumë çelik dhe 50 herë më shumë në baza të ndryshme materiale.

«Grupi me më pak të ardhura nga 60 amerikanët do të ishte më i pasur se mesatarja e pjesës tjetër të qytetit. Tamam pjesa më e madhe e popullsisë jo-amerikane do të ishte e varfër, në uri, e sëmurë dhe e pashkolluar. Rreth gjysma nuk do të mund të lexonte ose të shkruante. Më tepër se gjysma nuk do të kishin dëgjuar për Krishtin dhe çfarë Ai është. Por shumë shpejt më shumë se gjysma e botës do të dëgjonte për Karl Marks» (Fjalët në kllapa janë shtuar).

--Harri Smith Leiper.

Atëherë si do të konvertohet bota për Krishtin në këtë brez? Përgjigjja—vetëm nëpërmjet atyre që e duan Perëndinë me gjithë zemër dhe që e duan fqinjin e tyre si vetveten. Është vetëm devocioni dhe dedikimi që buron nga dashuria e vërtetë që do ta plotësojë këtë detyrë.

Për ata që janë në dashurinë e Krishtit, asnjë sakrificë për Të nuk është tepër e madhe. Ata do të veprojnë për arsye të dashurisë për Të, gjë që ata nuk do ta bënin për përfitim. Ata nuk do ta kursejnë jetën. Ata do të harxhojnë e do të harxhohen që njerëzit të mos humbasin pa Ungjillin.

«M'jep zemër si Jotja, o Zot i Kryq'zuar!
T'i dua njerëzit që vdesin, më mëso—
Zemrën sa më afër Teje ma mbaj;
Më jep dashuri—Dashuri t'vërtetë n'Kalvar
Që te Ti t'i sjell ata.»

--Xheims A. Stjuërd

Po që se dashuria nuk është motivi, atëherë shkak është i pashpresë. Nuk jep rezultat. Atëherë shërbimi nuk është asgjë tjetër përveç se zhurmë e veglave muzikore. Por kur dashuria është ylli udhëheqës, kur njerëzit shërbejnë me devocion për Krishtin, atëherë asnjë fuqi mbi tokë nuk mund ta ndalojë përhapjen e Ungjillit.

Atëherë, imagjini një grup dishepujsh, të dhënë së tëri pas Jezu Krishtit, të dhënë nëpërmjet dashurisë për Krishtin, duke mposhtur pengesat në vende të ndryshme për të deklaruar mesazhin e lavdishëm, duke ecur në mënyrë të pashtershme drejt zonave të reja në kërkim të çdo jete për të cilën Krishti vdiq, dhe duke pasur dëshirë të madhe që secili të jetë adhures i Krishtit në përjetësi. Çfarë metodash përdorin këta njerëz të tjerë të botës për ta deklaruar Krishtin?

Dhiata e Re na paraqet dy metoda kryesore për konvertimin e botës me Ungjillin. E para është nëpërmjet deklarimit publik; e dyta nëpërmjet dishepullimit individual.

Për sa i përket të parës, kjo metodë është përdorur nga Zoti Jezus dhe dishepujt e Tij. Sa herë që njerëzit mblidheshin së bashku, ekzistonte një mundësi për të predikuar lajmin e mirë. Kështu ne hasim takime ungjillore në pazare, në burgje, në vende të shenjta, në bregdet dhe gjatë luginave të lumenjve. Urgjenca dhe karakteri në shkallën më të lartë bëri që të mos i kushtojë tepër vëmendje vendit të takimit.

Metoda e dytë e përhapjes së besimit të krishterë është nëpërmjet dishepullimit të individëve. Kjo është metoda që Zoti Jezus përdori në përgatitjen e të dymbëdhjetëve. Ai e thirri këtë grup njerëzish që të ishin me Të dhe që t'i dërgonte në mision. Çdo ditë, Ai i udhëzoi ata në të vërtetën e Perëndisë. Ai caktoi detyrën që Ai kishte për ta. Ai i paralajmëroi për detajet, për rreziqet dhe vështirësitë që do të ndeshnin. Ai i mori ata në mbledhjet e Perëndisë dhe i bëri partnerë të Tij në planin e lavdishëm, por të vështirë

hyjnor. Pastaj i dërgoi në mision si delet midis ujqërve. Të fuqizuar nga Fryma e Shenjtë, ata u lëshuan përpara t'i tregonin botës për Shpëtimtarin e ngritur e të përlëvduar. Efektiviteti i kësaj metode shihet në faktin se grupi i dishepujve, i cili ra në njëmbëdhjetë për arsye të një tradhtari, e ktheu botën përmbyës për Zotin Jezu Krishtin.

Apostulli Pal jo vetëm që e vuri këtë metodë në praktikë për veten e tij, por i kërkoi Timoteut të bënte të njëjtën gjë. «Dhe ato që dëgjojnë nga unë përpara shumë dëshmitarëve, jepua njerëzve besnikë, që do të jenë të aftë të mësojnë edhe të tjerë» (2 Timoteut 2:2). Hapi i parë është zgjedhja me kujdes dhe me lutje e njerëzve besnikë. I dyti ka të bëjë me dhënien e këtij vizioni të lavdishëm të tjerëve. I treti ka të bëjë me dërgimin e këtyre njerëzve për të bërë dishepuj (Mat. 28:19).

Për ata që lakmojnë për numra të mëdhenj dhe turma të mëdha, kjo metodë do të duket jo shumë e mençur dhe e komplikuar. Por Perëndia e di se ç'po bën, dhe metodat e Tij janë metodat më të mira. Mund të arrihet më tepër për Perëndinë nëpërmjet disa dishepujve të dedikuar sesa nëpërmjet një armate fetarësh të vetëkënaqur.

Ndërsa këta dishepuj shkojnë në botë në Emrin e Krishtit, ata ndjekin parime të caktuara të Fjalës së Perëndisë. Së pari, ata janë të zgjuar si gjarpërinjtë, por të përlulur si pëllumbi. Për urtësi në udhën që kanë përpara, ata mbështeten te Trinia. Ndërkohë, ata janë të butë dhe të përlulur në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë. Askush nuk ka pse të frikësohet për ashpërsi nga ata; njerëzit duhet t'u frikësohen lutjeve të tyre dhe dëshmisë së tyre të pashuar.

Këta dishepuj qëndrojnë larg politikës së kësaj bote. Ata nuk e konsiderojnë veten të thirrur kundër ndonjë qeverie apo ideologjie politike. Ata mund të veprojnë në çfarëdo lloj qeverisjeje dhe t'i qëndrojnë besnik asaj qeverie deri në atë pikë ku u kërkohet të komprometojnë dëshminë e tyre dhe të mohojnë Zotin. Atëherë ata refuzojnë t'u binden dhe t'u nënshtrohen pasojave. Por ata kurrë nuk intrigojnë ndaj qeverive dhe nuk marrin pjesë në ndonjë taktikë revolucionare. A nuk tha Zoti: «Në qoftë se mbretëria Ime do të ishte e kësaj bote, atëherë shërbenjësit e Mi do të luftonin»? Këta njerëz janë ambasadorë të një vendi qiellor dhe kështu ata janë veçse kalimtarë e të huaj në këtë botë.

Ata janë absolutisht të ndershëm në çdo gjë. Ata i evitojnë gjërat e dyshuara. Fjala «po» është po dhe «jo» është jo. Ata refuzojnë të pajtohen me gënjeshtren e njohur se qëllimi i justifikon mjetet. Në asnjë mënyrë ata nuk bëjnë ligësi me qëllim që e mira të vijë. Secili prej tyre ka një ndërgjegje të tillë që më mirë do të vdiste sesa të mëkatonte.

Një parim tjetër i këtyre njerëzve është se ata e ankorojnë punën e tyre në kishën lokale. Ata shkojnë në botë për të fituar të konvertuar për Zotin Jezus, dhe kur fitojnë të konvertuar ata i sjellin në bashkësinë e kishës lokale ku mund të forcohen e të ndërtohen në besimin e tyre më të shenjtë. Dishepujt e vërtetë e kuptojnë se kisha lokale është mjete i Perëndisë në tokë për përhapjen e besimit dhe se puna më e mirë bëhet në bashkëpunim me të.

Dishepujt janë të zgjuar që nuk përfshihen në aleanca të ndonjë lloji. Ata refuzojnë me forcë dhe nuk lejojnë që lëvizjet e tyre të diktohen nga ndonjë organizatë njerëzore. Ata i marrin urdhrat direkt nga parajsa. Kjo nuk do të thotë se ata veprojnë pa fjalën dhe aprovimin e të krishterëve në kishën lokale. Përkundrazi, ata mbështeten në këtë aprovim si konfirmim i thirrjes së Perëndisë për shërbim. Por ata këmbëngulin në nevojën për t'i shërbyer Krishtit duke qenë të bindur ndaj Fjalës dhe drejtimit të Tij për ta.

Së fundi, këta dishepuj nuk kanë dëshirë të jenë me emër. Ata përpiqen të qëndrojnë prapa skenës. Qëllimi i tyre është të lavdërojnë Krishtin dhe ta shpallin Emrin e Tij. Ata nuk janë në kërkim të gjërave të mëdha për veten e tyre. Dhe gjithashtu nuk ia tregojnë strategjinë e tyre armikut. Kështu ata punojnë në qetësi dhe pa rënë në sy, të patrazuar nga lavdërimet apo fajësimet e njerëzve. Ata e dinë se «qielli do të jetë vendi më i mirë dhe më i sigurt për të parë rezultatet e punës së tyre».

Dishepullimi dhe jeta bashkëshortore

«Sepse ka eunukë që janë bërë vetë eunukë për mbretërinë e qiejve. Ai që mund të kuptojë, le të kuptojë» (Mateu 19:12).

Një nga pyetjet më të rëndësishme që dishepulli vihet përballë është nëse Perëndia e ka thirrur të martohet ose jo. Kjo është krejtësisht një çështje individuale midis Perëndisë dhe njeriut. Askush nuk mund të ndërmarrë veprime për dikë tjetër, të ndërhysh në të tilla është me rrezik.

Fjala e Perëndisë na mëson se martesë u dha nga Perëndia për racën njerëzore për qëllime të caktuara:

1. U dha për shoqëri dhe kënaqësi. Perëndia e pa se «nuk ishte mirë për njeriun të ishte i vetëm» (Zanafilla 2:18).
2. U dha për shtimin e racës. Kjo shihet në urdhëresën e Zotit: «Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën» (Zanafilla 1:28).
3. U dha për ruajtjen e vlerave morale në familje dhe shoqëri. «Për shkak të kurvërimit, le të ketë secili gruan e vet dhe secila grua burrin e vet» (1 Kor. 7:2).

Nuk thuhet askund në Fjalën e Perëndisë se martesë nuk i përshtatet jetës së kulluar, e me devocion dhe shërbim për Krishtin. Por, për më tepër, Bibla thotë se «martesë të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërljer» (Hebrenjve 13:4a). Fakti qëndron në atë se «kush ka gjetur një grua ka gjetur një gjë të mirë» (Fjalët e Urta 18:22). Fjalët e Predikuesit mund t'i aplikohen martesës: «Dy vlejné më mirë se një i vetëm», veçanërisht në qoftë se ata janë së bashku në shërbimin për Zotin. Vlefshmëria më e madhe e të qenit së bashku shihet në Ligjin e Përtërirë 32:30, ku një person ndjek një mijë veta dhe dy persona bëjnë që dhjetë mijë veta të ikin.

Prapëseprapë—megjithëse martesë është në vullnetin e Perëndisë për racën njerëzore në përgjithësi, kjo nuk do të thotë se ajo është vullneti i Tij për secilin njeri. Ndërsa kjo mund të shihet si një drejtë e dikujt, dishepulli i Zotit Jezus mund të zgjedhë të mos e ushtrojë këtë të drejtë me qëllim që të jetë më i dedikuar në shërbimin për Krishtin.

Zoti Jezus theksoi se do të kishte eunukë për hir të Tij në mbretërinë e Tij:

Sepse ka eunukë që kanë lindur të tillë nga barku i nënës; ka eunukë që janë bërë eunukë nga njerëzit, dhe ka eunukë që janë bërë vetë eunukë për mbretërinë e qiejve. Ai që mund të kuptojë, le të kuptojë (Mateu 19:12).

Kjo patjetër është një betim që personi bën si rezultat i dy faktorëve:

1. Një ndjenjë drejtimi nga Perëndia për të mos u martuar.
2. Një dëshirë për t'iu dedikuar i gjithi punës së Zotit pa përgjegjësitë e jetës familjare.

Kjo duhet të jetë bindje e një thirrjeje hyjnore (1 Kor. 7:7b). Vetëm nëpërmjet kësaj, dishepulli mund të jetë i sigurt se Zoti do t'i sigurojë hirin e duhur për vazhdimësi.

Së dyti, kjo duhet të bëhet vullnetarisht. Në rastin kur mosmartesë bëhet çështje detyrimi kishtar, ekziston një rrezik më i madh imoraliteti.

Apostulli Pal theksoi faktin se një i pamartuar shpeshherë mund t'i dedikohet më tepër punës së Mbretit:

I pamartuari merakoset për gjërat e Zotit, si mund t'i pëlqejë Zotit; por i martuari merakoset për gjërat e botës, si mund t'i pëlqejë gruas së tij» (1 Kor. 7:32, 33).

Për këtë arsye, ai shprehu dëshirën se të pamartuarit dhe gratë e veja është më mirë të qëndronin

si ai, d.m.th., të pamartuar (1 Kor. 7, 8).

Madje edhe për ata që tashmë ishin të martuar, apostulli ngul këmbë që ata t'i nënshtrorjnë gjithçka detyrës së madhe të deklarimit të Krishtit, ngaqë koha është e shkurtër:

Dhe po ju them këtë, o vëllezër, se koha tanimë është shkurtuar; kështu tash e tutje edhe ata që kanë gra të jenë si ata që nuk kanë; dhe ata që qajnë, sikurse të mos qanin; dhe ata që gëzohen, sikurse të mos gëzoheshin; dhe ata që blejnë, sikur të mos kishin gjë në zotërim; dhe ata që përdorin nga kjo botë, sikur të mos e përdornin, sepse forma e kësaj bote po kalon (1 Korintasve 7:29-31).

Kjo nuk do të thotë që burri të lërë pas dore përgjegjësitë e tij familjare, të braktisë gruan dhe fëmijët e të shkojë si misionar. Por kjo do të thotë që ai nuk duhet të jetojë për kënaqësitë dhe dëshirat e jetës. Ai nuk duhet të përdorë gruan dhe fëmijët si pretekste për t'i dhënë Krishtit vend të dytë në jetë.

C. T. Stud kishte frikë se e fejuara e tij do të ishte e zënë me të dhe se kështu Zoti Jezus nuk do të zinte vendin kryesor në jetën e saj. Për ta evituar këtë, ai kompozoi një varg për ta recituar çdo ditë:

Jezus të dua,
Më i dashur se Çarli
Mund t'jet'
për mua je Ti.

Komunistët kanë mësuar t'ia nënshtrorjnë çështjet familjare detyrës së madhe të pushtimit të njerëzimit me kauzën e tyre. Gordon Arnold Lonsdeil është një shembull i tillë. Pasi ai u kap në Angli për spiunazh për Rusinë, policia gjeti një letër nga gruaja e tij dhe një përgjigje prej gjashtë faqesh. Gruaja e tij shkruante; «Sa e padrejtë është jeta. E kuptoj plotësisht se po punon dhe se kjo është detyra jote dhe se ti e do punën dhe se e bën atë me tepër kujdes. Megjithatë, arsyetimi im është disi i ngushtë në atë të femrave, dhe vuaj keqas. Më shkruaj dhe më trego se si më do mua, dhe kështu ndoshta do të ndihem më mirë».

Lonsdeil u përgjigj, pjesërisht: «E gjitha që do të them është se vetë unë kam vetëm një jetë dhe jo një të lehtë. E gjitha që dua të bëj është ta kaloj jetën në mënyrë të tillë që kur të kthehem e të shikoj prapa të mos ketë vend për turp....Së shpejti do të bëhem 39 vjeç; a ka mbetur shumë kohë?»¹

«Koha tanimë është shkurtuar»—thotë Pali,—kështu tash e tutje edhe ata që kanë gra të jenë si ata që nuk kanë...».

Tragjedia qëndron në atë se martesë me ngut shpeshherë ka qenë një nga mjetet e djallit për devijimin e një dishepulli të ri nga udha e përdorimit të plotë për Krishtin. Shumë njerëz kanë humbur karrierën e tyre për shërbim për Zotin në momentin e martesës.

«Martesa [...] është një armik i ashpër në plotësimin e vullnetit të Krishtit në deklarimin e Tij. Martesa është e dhënë nga Perëndia. Por kur ajo bëhet pengesë për bërjen e vullnetit të Perëndisë, atëherë ajo është keqpërdorur. Mund të përmendim shumë—edhe burra, edhe gra—të cilët janë thirrur për të shkuar misionarë, por kurrë nuk kanë mundur ta arrijnë atë, për arsye se bashkëshortët i bënë që kjo të mos bëhej e mundur.... Asgjë, madje edhe bekimi me një bashkëshorte/bashkëshort, nuk duhet të bëhet pengesë për jetën e dikujt.... Sot njerëzit po vdesin pa Krishtin sepse të dashurit e tyre zënë një vend më të rëndësishëm se vullneti i Perëndisë»².

Kjo ndoshta është e vërtetë në rastet e punonjësve të parë se jeta beqare është e preferueshme. «Burra e gra të pararojës mund t'ju duhet madje të mohojnë edhe nevojat e jetës për të mos thënë asgjë për kënaqësitë e jetës, megjithëse plotësisht legjitime. Detyra e një të tilli është të qëndrojë i fortë në vështirësi, të jetë ushtar i mirë, i pamposhtur nga gjërat e jetës, atlet i pa penguar nga ndonjë peshë.... Kjo është një

¹ Revista «Koha» (Time Magazine), 17 Shkurt 1961.

² Gustafson, Uesli I. «Të thirrur, por shkuan» Çikago: Shtypshkronja IVCF, fq. 10.

pushim, një thirrje, një vajosje për shërbim të veçantë»³.

Për ata që e dëgjojnë këtë thirrje dhe që përgjigjen, ekziston një shpërblim i veçantë. Jezusi ka thënë: «Në të vërtetë po ju them [...] kushdo që ka lënë, për hir të Emrit Tim, shtëpi, vëllezër, motra, atë, nënë, grua, bij ose ara, do të marrë njëqindfish dhe do të trashëgojë jetë të përjetshme» (Mat. 19:28, 29).

Të marrim parasysh koston

Zoti Jezus kurrë nuk është munduar t'i bëjë njerëzit të besojnë në mënyrë tinëzare. Gjithashtu, Ai nuk u mundua t'u tërhiqte vëmendjen njerëzve me anë të një mesazhi të këndshëm për njerëzit.

Në fakt, sa herë që njerëzit mblidheshin pas Tij, Ai kthehej te ta duke i situar në termat më të rrepta të dishepullimit.

Në një nga këto raste, Zoti i paralajmëroi ndjekësit e Tij se ata duhet të kishin parasysh koston. Ai tha:

Kush nga ju, pra, kur do të ndërtojë një kullë, nuk ulet më parë të llogaritë shpenzimet, për të parë nëse ka mjaftueshëm për ta mbaruar? Që atëherë, kur t'i ketë hedhur themelet e të mos mundë ta përfundojë, të gjithë ata që e shohin, të mos fillojnë e të tallen, duke thënë: «Ky njeri filloi të ndërtojë e nuk mundi ta përfundojë». Ose cili mbret, kur niset të luftojë kundër një mbeti tjetër, nuk ulet më parë të gjykojë nëse mund ta përballojë me dhjetë mijë atë që po i vjen kundër me njëzet mijë? Në mos, ndërsa ai është ende larg, i dërgon një delegacion për të biseduar për paqe» (Lluka 14:28-32).

Ai këtu e krahasoi jetën e krishterë me ndërtimin e një objekti dhe me luftën.

Ai tha se është marrëzi të fillosh të ndërtosh një kullë pa marrë parasysh nëse ke fonde të mjaftueshme për ta përfunduar atë. Përndryshe, ndërtesa e papërfunduar do të qëndrojë si një monument i mosparashikimit të saktë.

E vërtetë! Është një gjë të ndërmarrësh një vendim për Krishtin ndërsa je në emocione në një takim ungjillor, por është krejtësisht një gjë tjetër të mohosh veten, të marrësh kryqin e Krishtit çdo ditë dhe ta ndjekësh Atë. Megjithëse nuk të kushton asgjë për t'u bërë i krishterë, të kushton mjaft për të ecur në mënyrë konstante si besimtar në udhën e flijimit, ndarjes nga bota dhe vuajtjeve për hir të Krishtit. Është një gjë ta fillosh mirë garën e krishterë, por është një gjë krejt e ndryshme ta kesh atë në mënyrë konstante, ditë pas dite, në kohë të mirë e të keqe, në mirëqenie e armiqësi, në çaste gëzimi e hidhërimi.

Bota kritike po vështron. Nëpërmjet njëfarë instinkti, ajo e kupton se jeta e krishterë ose meriton gjithçka ose nuk meriton asgjë. Kur sheh një të krishterë të dedikuar në shërbimin e Zotit, ajo mund të përqeshë, ta vërë në lojë e ta poshtërojë, por përbrenda ka një respekt të thellë për njeriun që mohon veten për Krishtin. Por kur sheh një të krishterë gjysmë të dedikuar, nuk shpreh asgjë por fillon sulmin. Ajo fillon ta poshtërojë atë, duke thënë: «Ky njeri filloi të ndërtonte, dhe nuk ishte i aftë ta mbaronte. Ai bëri mjaft zhurmë në konvertim, por tani është tamam si ne. Filloi me shpejtësi të madhe, por tani po xhiron në vend».

Dhe kështu Shpëtimtari thotë: «Kini parasysh çfarë do t'ju kushtojë!»

Shembulli i dytë i Tij ka të bëjë me një mbret, i cili po i shpallte luftë një tjetri. A nuk do të ishte e arsyeshme për të që së pari të shihte nëse 10 mijë ushtarët e tij do të ishin të aftë të fitonin mbi ushtrinë e armikut që ishte dy herë më e madhe? Sa absurde do të ishte në qoftë se ai do të shpallte luftë së pari dhe pastaj ndërsa ushtritë të ishin përballë njëra-tjetrës, ai të ndryshonte mendje. E vetmja rrugëdalje do të ishte të ngrinte flamurin e bardhë, dhe të dërgonte një skuadër për t'u dorëzuar, patjetër duke u zvarritur dhe duke kërkuar për të bërë paqe.

Nuk është aspak ekzagjerim ta krahasosh jetën e krishterë me luftën. Ekzistojnë armiqtë e

³ Kable dhe Frençm, «Ambasadorë për Krishtin», Çikago: Shtypshkronja «Moody.»

ashpër—bota, mishi dhe djalli. Ekzistojnë dekurajime, derdhje gjaku dhe vuajtje. Ekzistojnë orët e zgjatura të shikimit të personit që po vdes dhe pritja për agimin e mëngjesit. Ekzistojnë lotët, puna e vështirë dhe provokimet. Dhe ekziston vdekja e përditshme.

Gjithkush që vendos të ndjekë Krishtin duhet të ketë parasysh Getsemenin, Gabathën dhe Golgotën. Dhe pastaj ai duhet të ketë parasysh koston. Ajo ose është një përkushtim i plotë ndaj Krishtit, ose është një dorëzim me pretekste me gjithçka tjetër si mos nderim e degradim.

Me këta dy ilustrime, Zoti Jezus i paralajmëroi dëgjuesit e Tij për ndonjë vendim të shpejtë për t'u bërë dishepuj të Tij. Ai mund t'u premtonte atyre persekutim, keqtrajtim dhe vuajtje. Së pari, ata duhet të kenë parasysh koston!

Dhe cila është kostoja? Vargu i mëposhtëm i përgjigjet kësaj pyetjeje: «Kështu, pra, secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli Im» (Lluka 14:33).

Kostoja është të heqësh dorë nga «gjithçka»—gjithçka që një njeri është ose zotëron. Ishte e njëjta gjë për Shpëtimtarin; nuk mund të jetë diçka më pak për ata që e ndjekin Atë. Në qoftë se Ai, i cili ishte i pasur përtej përshkrimit u bë i varfër vullnetarisht, atëherë a do të fitonte kurorën e lavdisë me disa mjete më të pakushtueshme?

Pastaj Zoti Jezus e përfundoi fjalën e Tij me përmbledhjen e mëposhtme: «Kripa është e mirë, por nëse kripa bëhet e amësht, me se do të mund t'i kthehet shija?» (Lluka 14:34).

Në kohët e Biblës, duket sikur njerëzit nuk kishin kripë të pastër siç kemi ne sot në tryezat tona. Kripa e tyre kishte papastërti të ndryshme si rërë etj. Ishte si të thuash e mundshme që kripa të humbiste kripësinë; dhe ajo që mbetej ishte e pavlefshme. Nuk mund të përdorej as si pleh kimik as si dhe. Shpeshherë përdorej për të shtruar udhë këmbësore. Kështu, ajo «nuk vlen për asgjë, veçse për t'u hedhur dhe ta shkelin njerëzit» (Mateu 5:13).

Aplikimi i këtij ilustrimi është i qartë. Ekziston një qëllim kryesor i të qenit i krishterë—të përlëvdosh Perëndinë me një jetë që i dedikohet krejtësisht Atij. I krishteri e humbet shijen nëpërmjet mbledhjeve të pasurive në tokë, nëpërmjet plotësisht të rehatisë dhe kënaqësive të tij, nëpërmjet mundimeve për t'u bërë me famë në botë, duke i keqpërdorur jetën dhe talentet për gjëra të kota në këtë botë.

Në qoftë se besimtari humbet synimin kryesor të ekzistencës së tij, atëherë ai ka humbur gjithçka. Atëherë, jeta e tij është si kripa e pashije, për t'u shkelur nga njerëzit nëpërmjet përqeshjes, superioritetit dhe poshtëritimit të tyre.

Ja fjalët e fundit: «Ai që ka veshë, le të dëgjojë».

Shpeshherë, kur Zoti thoshte ndonjë thënie me peshë, Ai shtonte këto fjalë. Ishte sikur Ai ta dinte se të gjithë njerëzit nuk do t'i dëgjonin ato. Ai e dinte se disa do të mundoheshin t'i shpjegonin ato, për të thyer tehun e mprehtë të kërkesave të Tij.

Kështu Ai e la derën të hapur! «Ai që ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë». Ata që dëgjojnë janë ata që e marrin parasysh koston dhe thonë:

Kam vendosur t'ndjek Krishtin,
Megjith'se me askënd, un' Atë do ndjek,
Bota pas meje, Kryqi përpara,
S'kthehem mbrapsht, s'kthehem mbrapsht.

Hija e të rënit dëshmor

Kur një njeri i është përkushtuar Krishtit me të vërtetë, nuk ka rëndësi për të nëse vdes apo jeton. Gjithçka që ka rëndësi për të është përlëvdimi i Perëndisë.

Ndërsa lexoni TRIUMFIN E XHON DHE BETI STAMIT, do të shihni një shënim të përsëritur në gjithë librin—«që [...] Krishti të madhërohet në trupin tim, ose me jetën ose me vdekjen» (Fil. 1:20).

E njëjta gjë shihet edhe në shkrimet e Xhim Eliotit. Ndërsa akoma ishte student në Universitetin e Uitënit, ai shkroi në ditarin e tij: «Jam gati të vdes për fisin eukas».

Njëherë tjetër ai shkroi, «Atë, merrma jetën, po, gjakun në qoftë se dëshiron, dhe konsumoje atë me zjarrin Tënd përpirës. Nuk do ta kurseja atë, sepse nuk është i imi që ta kursej. Merre, O Zot, merre të gjithin. E derdh jetën time si një fljijm për botën. Gjaku ka vlerë vetëm po qe se rrjedh para altarit Tënd».

Duket sikur shumë nga heronjtë e Perëndisë arritën të njëjtin vend në marrëdhënien e tyre me Perëndinë. Ata e kuptuan se «nëse kokrra e grurit e rënë në dhe nuk vdes, ajo mbetet e vetme; por, po të vdesë, jep më shumë fryt!» Gjoni 12:24. Ata ishin gati të ishin ajo kokërr gruri.

Ky qëndrim është tamam çfarë Jezusi u mësoi dishepujve të Tij. «Sepse kush do ta shpëtojë jetën e vet, do të humbasë; por kush do ta humbasë jetën e vet për shkakun Tim, do ta shpëtojë» (Luka 9:24).

Sa më tepër që të mendojmë rreth kësaj, aq më e arsyeshme duket.

Së pari, jetët tona nuk na përkasin neve. I përkasin Atij që na vlerësoi me koston e gjakut të Tij të çmuar. A mund të qepemi pas asaj që është e Dikujt tjetër? C.T. Studiu përgjigj kësaj pyetjeje:

«Dija rreth vdekjes së Jezusit, por nuk e kisha kuptuar se në qoftë se Ai kishte vdekur për mua, atëherë unë nuk i përkisja më vetes. Shpengim do të thotë të riblesh, kështu në qoftë se unë i përkas Atij, atëherë unë ose do të isha vjedhës ose do të mbaja diçka që nuk është imja, ose përndryshe do të më duhej t'i dorëzoja gjithçka Perëndisë. Kur arrita të shoh se Jezus Krishti vdiq për mua, nuk ishte e vështirë t'i dorëzoja gjithçka Atij».

Së dyti, ne të gjithë do të vdesim sidoqoftë, në qoftë se Zoti nuk do të kthehet ndërkohë. A do të ishte një tragjedi më e madhe të vdisje duke i shërbyer Mbretit apo do të ishte një incident i thjeshtë statistikor? A nuk kishte të drejtë Xhim Elioti kur ai tha: «Nuk është budalla ai që jep çfarë nuk mund të mbajë për të fituar atë që nuk mund të humbasë».

Së treti, është e logjikshme se në qoftë se Zoti Jezus vdiq për ne, gjëja më e vogël që ne mund të bënim është të vdisnim për Të. Në qoftë se shërbyesi nuk është mbi zotëruesin e tij, atëherë çfarë të drejtë kemi ne për të shkuar në parajsë më rehatisht sesa Zoti Jezus? Ishte kjo gjë që e bëri Studin të thoshte: «Në qoftë se Krishti është Perëndia dhe vdiq për mua, atëherë asgjë që unë mund të bëj, nuk është tepër e madhe».

Së fundi, është krim të mbahemi pas jetës sonë, ndërkohë kur nëpërmjet braktisjes së saj, të tjerët mund të bekohen. Shpeshherë njerëzit e ofrojnë jetën e tyre për interes të kërkimeve shkencore në mjekësi. Të tjerët japin jetën për të shpëtuar të afërmit e tyre në raste zjarri. Akoma të tjerë japin jetën në betejë për të mbrojtur vendin e tyre nga armiku. Ç'vlerë ka jeta për ne? A mund të themi njëzëri me F. W. H. Myers:

«Vetëm shpirtra të njëjtë shoh atje,
N'pranga n'vend që t'pushtojnë e skllëvër n'vend që t'ishin mbretër.
Me një shpresë t'vetme me një mrekulli bosh,
Fatkeqësisht t'vënë përballë një sërë gjërash.

«Pastaj menjëherë një dëshirë e patolerueshme
Më përshkon si një thirrje trumpete—
O, për t'i shpëtuar këta! Për t'humbur për ta,
Vdis për jetën e tyre, ofroje veten për t'gjitha ato.

Jo të gjithëve u është kërkuar të japin jetën e tyre si dëshmorë. Turra e druve, heshta, dhe ekzekutimi etj., janë vetëm për disa. Por secili nga ne mund ta ketë frymën dëshmore, zellin dëshmor dhe devocionin dëshmor. Secili nga ne mund të jetojë si ata që tashmë ia kanë dorëzuar jetën e tyre Krishtit.

«Eja i sëmurë, eja i shëndetshëm, kryqi, kurora,
Ylberi dhe bubullima;
E hedh frymën dhe trupin tim përtokë»,

Që Perëndia ata t'i plugojë».

Shpërblimet për dishepujt e vërtetë

Jeta që i është dorëzuar Zotit Jezus ka shpërblimet e saj të mëdha. Ekziston gëzim dhe kënaqësi në ndjekjen e Krishtit, që në fakt është jeta e vërtetë.

Herë pas here Shpëtimtari tha: «Ai që do të humbasë jetën e vet për hirin Tim, do ta gjejë përsëri». Në fakt, kjo thënie e tij gjendet në katër Ungjijtë më shpesh sesa ndonjë thënie tjetër e Tij (shihni Mateu 10:39; 16:25; Marku 8:35; Lluka 9:24; 17:33; Gjoni 12:25). Pse është përsëritur kaq shpesh? A nuk i hap rrugë njërit nga parimet më themeltare të jetës së krishterë se jeta e ruajtur për veten është jetë e humbur, por jeta që i jepet Atij është jetë e gjetur, e shpëtuar, e shijuar, dhe e ruajtur në përjetësi?

Të jesh i krishterë gjysmë i përkushtuar mund të sigurojë veçse një ekzistencë të tmerrshme. T'i dorëzosh gjithçka atij është mënyra më e mirë për të shijuar gjithçka të Tij.

Të jesh dishepull i vërtetë do të thotë të jesh skllav i Jezus Krishtit dhe të zbulosh se shërbimi për Të është liria e vërtetë. Ekziston liri në të gjithë ata që thonë: «E dua Zotëruesin tim; nuk do të largohem prej Tij».

Dishepulli nuk trazohet nga gjëra të vogla. Ai e përqendron vëmendjen në gjërat e përjetshme, dhe ashtu si Hadsën Tejlëri e shijon luksin për t'u kujdesur veçse për pak gjëra.

Ai mund të jetë i panjohur, por ama ai është i njohur. Nëpërmjet vdekjes në mënyrë konstante, ai jeton me këmbëngulje. Ai dënohet por nuk vritet. Madje edhe në fatkeqësi, ai ngazëllon. Megjithëse vetë i varfër, ai i bën të tjerët të pasur. Ai vetë nuk zotëron asgjë, por në fakt ai zotëron gjithçka (2 Korintasve 6:9, 10).

Dhe në qoftë se mund të thuhet se jeta e vërtetë e një dishepulli është jeta frymërore më e kënaqshme në këtë botë, atëherë në të njëjtën mënyrë, mund të thuhet se ajo do të jetë më e shpërblyera në jetën që vjen. «Sepse Biri i njeriut do të vijë në lavdinë e Atit të vet bashkë me engjëjt e Tij; dhe atëherë Ai do të shpërblejë secilin sipas veprës së tij» (Mateu 16:27).

Kështu, njeriu më i bekuar vërtetë në kohë dhe përjetësi është ai që mund të thotë me Borden e Yale: «Zot Jezus, Unë heq dorë nga jeta. Të vë Ty në fronin e jetës time. Më ndrysho, më pastro, më përdor si të duash».

Ai nuk donte

«'Ai nuk donte që ndokush të humbasë;'
Jezusi në fronin e lavdisë n'qiell,
E pa botën e rënë n'mëkat, dhe pa trishtimin tonë,
Jetën e Tij për ne dha, dashuri e vërtet!
Po kalon, po kalon! T'mbledhur n'udhën tonë,
Thyhen zemrat me barrë tepër të rëndë,
Jezusi shpëton, por s'ka askënd kush t'u tregojë,
Askush që t'i ngrrejë nga mëkati e trishtimi.

«'Ai nuk donte që ndokush të humbasë:'
I veshur në mishin tonë me trishtimin dhe dhimbje,
Erdhi Ai të shpëtonte të humburit, të ngushëllonte vajtuesin,
Të shëronte zemrën e thyer nga trishtimi e turpi.
Po kalon, po kalon! E korra po kalon,
Korrësit janë të paktë dhe nata po afrohet:

Jezusi po të thërret, nxito te e korra,
Do kesh frymë të çmueshme për punën tënde.

«Shumë për kënaqësi, por pak për Jezusin;
Kohë për botën me shqetësimet e lojërat e saj,
Aspak kohë për punën për Jezusin, për t'ushqyer t'uritit.
Për t'sjellë frymët e humbura në gëzimet e përjetësisë.
Po kalon, po kalon! Dëgjoni, si po na thërrasin;
Na sillni Shpëtimtarin tuaj, o na tregoni për Të!
Jemi tepër t'lodhur, kaq shumë t'munduar,
Dhe me shumë të qara sytë na janë errësuar.

«'Ai nuk deshi që ndokush të humbasë:'
A jam ndjekës i Tij, dhe a mund t'jetoj
Më gjatë pa u trazuar me një frymë drejt të tatëpjetës
I humbur për mungesë të ndihmës që mund të jap?
Po kalon, po kalon! Ti nuk do;
Zot, më fal, dhe më rino;
Zhduki gjërat e botës në ne, na ndihmo
t'jetojmë duke pasur parasysh vlerat e përjet'sisë».

- Luci R. Meier.